



Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi: PËRVOJË, VIZION DHE LIDERSHIP

» faqe 2



MINISTRI NUFİ: MODERNIZIMI I FORCAVE TË ARMATOSURA DHE FORCIMI I KAPACITETEVE MBROJTËSE NË FOKUS TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Z. Ermal Nufi ka marrë zyrtarisht detyrën në krye të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, në një ceremoni të posaçme të zhvilluar në Garnizonin "Skënderbej". Detyra iu dorëzua nga ministri në largim, Pirro Vengu, në prani të drejtuesve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralëve dhe partnerëve ndërkombëtarë. Në fjalën e tij të parë si ministër i Mbrojtjes, z. Nufi theksoi përgjegjësinë që mbart ky institucion për sigurinë e vendit dhe...

faqe 3



PREKAZI I MARTIRËVE - KUJTESA E GJALLË E DËSHMORËVE TË KOSOVËS

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Prekazi: Historia e Guximit dhe Sakrificës. 5-7 mars 1998, 58 shqiptarë ranë për lirinë e Kosovës. Sot kujtesa e tyre na flet. Ndërsa vizitoja Prekazin e Ulët, ndjeva fuqinë e historisë dhe peshën e sakrificës së familjes Jashari. Vendosmëria e tyre për të qëndruar deri në fund, për të mbrojtur dinjitetin dhe lirinë...

faqe 6



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA NË PANAIRIN "WORK & STUDY 2026"

Akademia e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë po merr pjesë aktive në panairin kombëtar "Work & Study 2026", një aktivitet i rëndësishëm informues dhe orientues për maturantët dhe të rinjtë që janë në prag të zgjedhjes së studimeve universitare dhe të rrugës së tyre profesionale. Ky panair po zhvillohet në disa qytete të vendit dhe synon të krijojë një hapësirë komunikimi të drejtpërdrejtë mes institucioneve arsimore dhe të rinjve që synojnë të ndërtojnë të ardhmen e tyre akademike dhe profesionale. Në këtë kuadër, përfaqësues...

faqe 5

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi: Përvojë, vizion dhe leadership

Që prej marsit të vitit 2026, z. Ermall Nufi mban detyrën e ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, një përgjegjësi e rëndësishme në drejtimin dhe zhvillimin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë së vendit. Në këtë rol ai udhëheq strategjinë e sektorit të mbrojtjes, duke kontribuar në forcimin e rolit të Shqipërisë në strukturat euroatlantike dhe në modernizimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Detyra e ministrit të Mbrojtjes në një vend anëtar të NATO-s kërkon vizion strategjik, aftësi koordinuese dhe një qasje të balancuar mes politikës, diplomacisë dhe sigurisë kombëtare. Në këtë kuadër, drejtimi i ministrisë nga z. Ermall Nufi synon të forcojë kontributin e Shqipërisë në aleancën euroatlantike, të zhvillojë më tej kapacitetet mbrojtëse të vendit dhe të thellojë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Drejtimi i politikave të mbrojtjes dhe sigurisë

Në detyrën e ministrit të Mbrojtjes, z. Ermall Nufi ka në fokus zhvillimin e politikave që synojnë modernizimin e forcave të armatosura, rritjen e kapaciteteve operacionale dhe përmirësimin e ndërveprueshmërisë me aleatët e NATO-s. Një nga objektivat kryesore të kësaj periudhe është forcimi i rolit të Shqipërisë si një partner i besueshëm në arkitekturën euroatlantike të sigurisë. Kjo përfshin kontributin në misionet dhe operacionet e NATO-s, zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes kombëtare dhe përmirësimin e infrastrukturës ushtarake në përputhje me standardet e aleancës. Në të njëjtën kohë, ministria e Mbrojtjes është e përfshirë në avancimin e bashkëpunimit strategjik me partnerët ndërkombëtarë të sigurisë dhe mbrojtjes, duke zhvilluar projekte të përbashkëta dhe duke forcuar dialogun me vendet aleate.

Përvoja në administratën qendrore

Para emërimit në krye të Ministrisë së Mbrojtjes, z. Ermall Nufi ka shërbyer si zëvendëssekretar i Përgjithshëm i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë funksion ai ka luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin ndërinstitucional dhe në mbështetjen e proceseve të politikëbërjes në nivel qendror të qeverisjes.

Në këtë detyrë ai ka qenë i përfshirë në mbështetjen e proceseve vendimmarrëse të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar në koordinimin e iniciativave ligjore dhe institucionale në nivel qeveritar.

Roli i zëvendëssekretarit të Përgjithshëm në Kryeministri kërkon një njohje të thellë të mekanizmave të administratës publike dhe të proceseve të hartimit dhe zbatimit të politikave publike. Përvoja e fituar në këtë funksion i ka dhënë z. Ermall Nufit një perspektivë të gjerë mbi qeverisjen dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

Formimi akademik dhe karriera ligjore

Formimi profesional i z. Ermall Nufit është i lidhur ngushtë me fushën e drejtësisë. Ai ka përfunduar studimet master në Drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë në vitin 2010.

Pas përfundimit të studimeve universitare, ai ka ushtruar profesionin si avokat dhe konsulent ligjor, duke punuar si në sektorin privat, ashtu edhe me organizata vendase dhe ndërkombëtare. Aktiviteti i tij profesional është përqendruar kryesisht në fushat e së drejtës civile dhe tregtare, si dhe në çështjet e qeverisjes korporative.

Që prej vitit 2013 ai është i licencuar si avokat nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë. Gjithashtu ka shërbyer si anëtar i Këshillit Drejtues të Dhomës së Avokatëve të Tiranës, duke kontribuar në zhvillimin dhe përfaqësimin institucional të profesionit të avokatit.

Përvoja në kabinetet qeveritare

Në karrierën e tij profesionale, z. Ermall Nufi ka mbajtur edhe funksione të rëndësishme në kabinetet qeveritare. Ai ka shërbyer si këshilltar ligjor pranë ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, ku ka kontribuar në analizën dhe hartimin e çështjeve ligjore që lidhen me sektorët strategjikë të infrastrukturës dhe



energjisë. Gjithashtu, ai ka mbajtur detyrën e drejtorit të kabinetit të zëvendëskryeministrit, një funksion që kërkon aftësi organizative dhe koordinuese në nivel të lartë të administratës publike.

Në këtë rol ai ka qenë i përfshirë në koordinimin e politikave dhe iniciativave institucionale, duke mbështetur proceset e vendimmarrjes në nivel qeveritar.

Angazhimi në bordet drejtuese të institucioneve

Një pjesë e rëndësishme e përvojës profesionale të z. Ermall Nufit lidhet edhe me përfshirjen e tij në bordet drejtuese të institucioneve publike dhe të sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes. Me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ai është emëruar kryetar i Bordit Menaxhues të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe anëtar i Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Në cilësinë ex officio ai ka kryesuar gjithashtu Bordin e Agjencisë Shtetërore të Informacionit Gjeohapësinor, duke kontribuar në drejtimin dhe koordinimin e politikave në këtë fushë. Një tjetër rol i rëndësishëm në karrierën e tij ka qenë drejtimi i bordit të KAYO sh.a., një shoqëri që operon në industrinë e mbrojtjes dhe sigurisë. Kjo kompani ofron produkte dhe shërbime për Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe për tregjet ndërkombëtare, duke përfaqësuar një segment të rëndësishëm të industrisë së mbrojtjes.

Përfshirja në këto struktura drejtuese i ka dhënë atij përvojë në menaxhimin institucional dhe në drejtimin strategjik të organizatave publike dhe të sektorit të sigurisë.

Një profil i ri drejtues në sektorin e mbrojtjes

Emërimi i z. Ermall Nufit në krye të Ministrisë së Mbrojtjes përfaqëson një fazë të re në drejtimin e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit. Me një përvojë të konsoliduar në fushën ligjore, në administratën publike dhe në strukturat drejtuese institucionale, ai sjell në këtë detyrë një qasje që ndërthur dimensionin juridik, administrativ dhe strategjik të politikave të mbrojtjes. Në një kontekst ndërkombëtar, ku sfidat e sigurisë janë gjithnjë e më komplekse, roli i ministrit të Mbrojtjes është thelbësor për garantimin e stabilitetit dhe për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit. Në këtë drejtim, puna e Ministrisë së Mbrojtjes dhe e Forcave të Armatosura të Shqipërisë mbetet një element kyç për sigurinë kombëtare dhe për kontributin e Shqipërisë në arkitekturën euroatlantike të mbrojtjes.

Jeta personale

Përtej angazhimeve profesionale dhe institucionale, ministri Nufi është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Si shumë drejtues të institucioneve shtetërore, ai përpiqet të ruajë një ekuilibër mes përgjegjësive publike dhe jetës familjare, duke e konsideruar familjen një mbështetje të rëndësishme në përballimin e sfidave të detyrës.

Në emër të stafit të gazetës “Ushtria”, shprehim urimet më të sinqerta për z. Ermall Nufi për detyrën e lartë si Ministër i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Urojmë që përvoja, profesionalizmi dhe përkushtimi juaj të vazhdojnë të shërbejnë në forcimin e Forcave të Armatosura dhe të sigurisë kombëtare, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit dhe prestigjit të vendit tonë në arenën ndërkombëtare!



MINISTRI NUFI: Modernizimi i Forcave të Armatosura dhe forcimi i kapaciteteve mbrojtëse në fokus të Ministrisë së Mbrojtjes

Z. Ermal Nufi ka marrë zyrarisht detyrën në krye të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, në një ceremoni të posaçme të zhvilluar në Garnizonin “Skënderbej”. Detyra iu dorëzua nga ministri në largim, Pirro Vengu, në prani të drejtuesve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralëve dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Në fjalën e tij të parë si ministër i Mbrojtjes, z. Nufi theksoi përgjegjësinë që mbart ky institucion për sigurinë e vendit dhe për rolin e Shqipërisë në arkitekturën e sigurisë ndërkombëtare.

“Sot marr detyrën si ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë me një ndjenjë të thellë nderi, por mbi të gjitha me vetëdijen e plotë për përgjegjësinë që mbart ky institucion për sigurinë e vendit tonë”, – u shpreh ministri Nufi.

Ai falënderoi kryeministrin për besimin e dhënë, ndërsa vlerësoi edhe kontributin e paraardhësit të tij, Pirro Vengu, në drejtimin e institucionit dhe në mbështetje të Forcave të Armatosura.

Në vijim të fjalës së tij, ministri Nufi theksoi se siguria kombëtare ndërtohet mbi përkushtimin e njerëzve që shërbejnë në uniformë dhe mbi bashkëpunimin institucional.

“Siguria e një vendi nuk ndërtohet vetëm me strategji apo dokumente të qarta politikisht dhe doktrinalisht. Ajo ndërtohet çdo ditë nga njerëzit, nga burrat dhe gratë që veshin uniformën, nga komandantët dhe drejtuesit që marrin vendime të vështira, nga institucionet që qëndrojnë të forta edhe në kohë pasigurie. Prandaj sot dua të shpreh respektin tim më të thellë për çdo pjesëtar të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, stafet civile e administrative pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes, të Emergjencave Civile dhe çdo institucioni varësie të kësaj ministrie”, – theksoi ministri i Mbrojtjes.

Ministri Nufi nënvizoi gjithashtu se një nga prioritetet kryesore të mandatit të tij do të jetë modernizimi i Forcave të Armatosura, zhvillimi i kapaciteteve mbrojtëse dhe



forcimi i rolit të Shqipërisë në aleancat ndërkombëtare.

“Një nga prioritetet e kësaj ministrie, sipas vullnetit politik të kryeministrit mbetet zhvillimi dhe modernizimi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, rijetësimi i industrisë ushtarake, rritja e kapaciteteve për përballimin e emergjencave civile si dhe hapja e rrugës drejt inovacionit në fushën e mbrojtjes, në përputhje të plotë me standardet e NATO-s për të garantuar efektivitetin e të gjitha strukturave tona”, – u shpreh ai.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes theksoi gjithashtu rëndësinë e rolit të NATO-s si garancia më e fortë për sigurinë e vendit dhe angazhimin e Shqipërisë si një aleate aktive dhe e besueshme në kuadër të Aleancës.



Kursantët e KLO-së zhvillojnë aktivitet akademik në Akademinë e Mbrojtjes në Mbretërinë e Bashkuar

Kursantët e Kursi i Lartë i Oficerit (KLO), nën drejtimin e stafit pedagogjik të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, po zhvillojnë një aktivitet akademik në Akademinë e Mbrojtjes, Shrivenham në Mbretërinë e Bashkuar, me fokus mbi temën “Procesi i Planifikimit Operacional (PPO)”.

Kursantët janë të shoqëruar nga David Strong, Atasheu Ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar i akredituar në Tiranë. Në mbërritje, pjesëmarrësit u pritën nga stafi akademik i institucionit, i cili u uroi mirëseardhjen dhe prezantoi programin e aktivitetit. Në vijim, kursantët ndoqën një prezantim mbi procesin e planifikimit operacional nga Drejtori i Kursit, kapiten i Marinës Mbretërore Charlie Yemen. Në kuadër të këtij aktiviteti, kursantët u ndanë në sindikata të përbashkëta me kursantët e Kursi i 29 i Avancuar i Shtabit, duke u angazhuar në diskutime dhe shkëmbime mendimesh mbi zhvillimin e procesit të planifikimit operacional dhe mbi praktikat më të mira në këtë fushë.

Gjatë ditës së dytë të aktivitetit, pjesëmarrësit ndoqën një leksion mbi komandim-kontrollin dhe mbi konceptin e qendrave të gravitetit, të trajtuar nga gjeneral brigade James Lewis. Procesi i planifikimit operacional në sindikata u ndoq gjithashtu nga Atasheu Ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, kolonel Roland Shuli.

Ky aktivitet, i mbështetur nga Atasheu Ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar rezident në Tiranë, do të vijojë deri në fund të javës, duke ofruar një përvojë të vlefshme akademike dhe profesionale për kursantët, si dhe duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e planifikimit operacional.



Batalioni i Xhenios monton urë metalike “Bailey” në Lozhan

Kompania e Urave, pjesë e Batalionit të Xhenios, po realizon një operacion xhenier për montimin e një ure metalike të tipit “Bailey” në fshatin Lozhan, Njësia Administrative Moglicë, Bashkia Maliq.

Ura, me gjatësi 15 metra dhe seksion 2/1, po vendoset mbi Lumin Devoll dhe do të sigurojë kalueshmërinë në segmentin rrugor që lidh fshatrat Gjçinikas dhe Osojë. Ky projekt do të lehtësojë lëvizjen e banorëve dhe qarkullimin e mjeteve në zonën e prekshme, duke rritur sigurinë dhe aksesin në infrastrukturën lokale. Operacioni i Batalionit të Xhenios për montimin e urës është një shembull i përpjekjeve të Forcave të Armatosura për të mbështetur komunitetet lokale dhe për të garantuar infrastrukturë të qëndrueshme në zonat rurale.



Forca Tokësore mbyll fushatën vullnetare të dhurimit të gjakut

Njësitë e Forcës Tokësore kanë përmbyllur me sukses fushatën e dhurimit të gjakut në bazë vullnetare, një aktivitet humanitar i zhvilluar në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ).

Në kuadër të kësaj nisme, efektive të QAPU-së Vlorë iu bashkuan fushatës duke dhënë kontributin e tyre për njerëzit në nevojë, duke treguar solidaritet dhe përgjegjshmëri qytetare. Dhurimi i gjakut u realizua në mënyrë të organizuar dhe sipas standardeve të sigurisë dhe higjienës, duke përfshirë gjithë efektivistë e intere-suar. Një falënderim i veçantë i është shprehur të gjithë pjesëmarrësve për përkushtimin dhe gatishmërinë e tyre për të kontribuar në shpëtimin e jetëve. Ky aktivitet është një shembull i bashkëpunimit dhe solidaritetit të Forcave të Armatosura me komunitetin dhe tregon se edhe një gjest i thjeshtë vullnetar mund të bëjë një ndryshim të madh në jetën e njerëzve në nevojë.



Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen zhvillon vizitë studimore në rajonin jugperëndimor të vendit

Në kuadër të zbatimit të programit mësimor “Team Building”, Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-16) zhvilloi një vizitë studimore në rajonin jug-perëndimor të Shqipërisë gjatë periudhës 10-12 mars 2026. Kjo vizitë u realizua me qëllim njohjen nga afër të funksionimit të institucioneve vendore, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe thellimin e njohurive mbi vlerat historike, kulturore dhe turistike të këtij rajoni.

Gjatë ditës së parë të vizitës, delegacioni i KLSM-16 u prit në Prefekturën e Fierit nga prefekti Anduel Xhindi, i cili u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe i njohu me organizimin, detyrat dhe angazhimet aktuale të institucionit që drejton, si edhe me bashkëpunimin me strukturat e tjera shtetërore. Në vijim të programit, në sesionin e pasdites, pjesëmarrësit zhvilluan një takim në Prefekturën e Vlorës me prefekten Evis Allushi. Gjatë këtij takimi, ajo prezantoi organigramën e institucionit, prioritetet aktuale dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera, përfshirë edhe Forcat e Armatosura, veçanërisht në rastet e emergjencave civile.

Programi vijoi me një vizitë në Bashkinë e Sarandës, ku stafi drejtues dhe grupi i kursit u pritën nga zëvendëskryetari i bashkisë. Gjatë takimit, pjesëmarrësit u njohën me zhvillimin ekonomik dhe turistik të qytetit, me vlerat historike të zonës si dhe me bashkëpunimet institucionale të bashkisë me strukturat e tjera shtetërore, përfshirë Forcat e Armatosura në raste të veçanta.

Në kuadër të aktiviteteve kulturore dhe njohëse, pjesëmarrësit zhvilluan një vizitë në Parkun Kombëtar të Butrintit, një nga sitet më të rëndësishme arkeologjike dhe kulturore të vendit.



Gjatë ditës së tretë të programit, stafi drejtues dhe pjesëmarrësit e KLSM-16 vizituan pikën turistike “Syri i Kaltër”, në fshatin Muzinë të rrethit të Delvinës, i njohur si një nga burimet karstike më të rralla në Ballkan.

Vizita vijoi në qytetin e Gjirokastrës, ku delegacioni u prit nga prefektja e qarkut, Albana Hasanaj. Ajo i njohu pjesëmarrësit me historinë, trashëgiminë kulturore dhe harmoninë komunitare që karakterizon këtë qytet. Në përfundim të programit, u zhvillua një vizitë në Kalanë e Gjirokastrës, një nga monumentet më të rëndësishme historike dhe kulturore të Shqipërisë.

Kjo vizitë studimore shërbeu për pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen jo vetëm si një mundësi për të njohur nga afër rolin dhe angazhimet e institucioneve vendore, por edhe për të thelluar njohuritë mbi historinë, traditat dhe kulturën e vendit tonë.

Nëndetësja turke TCG “İnönü”, vizitë treditore në Portin e Durrësit

Nëndetësja turke TCG İnönü ka mbërritur në Portin e Durrësit për një vizitë treditore, në kuadër të bashkëpunimit mes forcave detare të vendeve aleate dhe forcimit të marrëdhënieve ushtarake në rajon. Sipas Autoritetit Portual Durrës, për pritjen dhe qëndrimin e nëndetëses janë marrë të gjitha masat e nevojshme organizative, në mënyrë që vizita të zhvillohet normalisht dhe pa pengesa. Institucionet përkatëse kanë bashkëpunuar ngushtë me Forcën Detare të Shqipërisë dhe Policinë Ushtarake të Shqipërisë për të siguruar akomodimin e ekuipazhit, si dhe për të garantuar masat e sigurisë gjatë qëndrimit të tyre në qytetin bregdetar. Kjo vizitë konsiderohet një tjetër tregues i bashkëpunimit të qëndrueshëm mes Shqipërisë dhe Turqisë në fushën detare dhe atë të sigurisë. Vizita të tilla janë pjesë e praktikës së rregullt mes forcave detare të vendeve partnere dhe synojnë forcimin e koordinimit, shkëmbimin e përvojave profesionale dhe rritjen e bashkëpunimit në rajon, në funksion të sigurisë dhe stabilitetit në hapësirën detare.



Akademia e Forcave të Armatosura në panairin “Work & Study 2026”

Orientim për maturantët drejt studimeve dhe karrierës ushtarake në shërbim të vendit

Akademia e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë po merr pjesë aktive në panairin kombëtar “Work & Study 2026”, një aktivitet i rëndësishëm informues dhe orientues për maturantët dhe të rinjtë që janë në prag të zgjedhjes së studimeve universitare dhe të rrugës së tyre profesionale. Ky panair po zhvillohet në disa qytete të vendit dhe synon të krijojë një hapësirë komunikimi të drejtpërdrejtë mes institucioneve arsimore dhe të rinjve që synojnë të ndërtojnë të ardhmen e tyre akademike dhe profesionale. Në këtë kuadër, përfaqësues të Akademisë së Forcave të Armatosura kanë zhvilluar një sërë takimesh informuese me maturantë në qytete të ndryshme të vendit, duke prezantuar programet e studimit, mundësitë e zhvillimit profesional dhe perspektivat e një karriere në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Aktivitetet janë zhvilluar në qytete si Fier, Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë, Sarandë, Dibër, Korçë dhe në shumë qytete të tjera të vendit, duke e shtrirë këtë iniciativë informuese në një pjesë të madhe të territorit të Shqipërisë.

Një mundësi për të njohur nga afër studimet ushtarake

Panairi “Work & Study 2026” është shndërruar në një platformë të rëndësishme ku maturantët mund të marrin informacion të drejtpërdrejtë nga institucionet arsimore mbi programet e studimit dhe perspektivat e karrierës. Në këtë kuadër, stafi i Akademisë së Forcave të Armatosura ka prezantuar para maturantëve programet akademike të ciklit “Bachelor”, të cilat përbëjnë bazën e formimit profesional



për oficerët e ardhshëm të Forcave të Armatosura. Gjatë këtyre prezantimeve, të rinjtë janë njohur me strukturën e programeve të studimit, disiplinat akademike dhe praktikat profesionale që zhvillohen gjatë periudhës së studimit në akademi. Gjithashtu, është theksuar rëndësia e formimit akademik dhe profesional për ndërtimin e një karriere të suksesshme në strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë. Përfaqësuesit e akademisë kanë shpjeguar në detaje edhe kushtet dhe kriteret e pranimit për studentët e rinj, procedurat që duhet të ndjekin maturantët për t’u bërë pjesë e këtij institucioni dhe fazat e procesit të përzgjedhjes. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe mundësive që ofron akademia për zhvillimin profesional të studentëve gjatë dhe pas përfundimit të studimeve.

Studime dhe mundësi zhvillimi brenda dhe jashtë vendit

Një nga aspektet që ka tërhequr më shumë interesin e maturantëve gjatë takimeve informuese ka qenë mundësia për të vazhduar studimet dhe trajnimet në institucione ushtarake dhe akademike jashtë vendit. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar që zhvillon Akademia e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me institucione homologe dhe me partnerët ndërkombëtarë të sigurisë dhe mbrojtjes, studentët kanë mundësi të marrin pjesë në programe shkëmbimi, trajnime dhe specializime në akademi ushtarake të vendeve partnere.

Këto programe përbëjnë një mundësi të rëndësishme për rritjen e nivelit profesional të oficerëve të rinj dhe për përgatitjen e tyre sipas standardeve bashkëkohore të mbrojtjes dhe sigurisë. Në të njëjtën kohë, ato kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përmirësimin e kapaciteteve profesionale të Forcave të Armatosura shqiptare.

Gjatë takimeve me maturantët është theksuar gjithashtu se studimi në Akademinë e Forcave të Armatosura nuk



përfaqëson vetëm një formim akademik, por edhe një përgatitje të plotë profesionale dhe fizike për një karrierë në shërbim të vendit. Studentët përfitojnë një trajnim të strukturuar që përfshin formimin akademik, disiplinën ushtarake, zhvillimin e aftësive drejtuese dhe përgatitjen fizike.

Interes i lartë nga të rinjtë

Pjesëmarrja e Akademisë së Forcave të Armatosura në panairin “Work & Study 2026” është shoqëruar me një interes të konsiderueshëm nga maturantët në qytetet ku janë zhvilluar aktivitetet informuese. Të rinjtë kanë shfaqur kureshtje për programet e studimit, për mundësitë që ofron akademia dhe për perspektivat e një karriere në Forcat e Armatosura. Gjatë bashkëbisedimeve të zhvilluara në këto aktivitete, maturantët kanë pasur mundësinë t’iu drejtojnë pyetje përfaqësuesve të akademisë dhe të marrin informacion të detajuar mbi jetën studentore, procesin e formimit ushtarak dhe perspektivat e zhvillimit profesional pas përfundimit të studimeve. Stafi i akademisë u është përgjigjur me profesionalizëm dhe transparencë të gjitha pyetjeve të maturantëve, duke i orientuar ata mbi hapat që duhet të ndjekin për të aplikuar dhe për t’u bërë pjesë e këtij institucioni arsimor dhe ushtarak. Në këtë mënyrë, panairi ka shërbyer jo vetëm si një aktivitet informues, por edhe si një mundësi për të krijuar një dialog të drejtpërdrejtë mes të rinjve dhe përfaqësuesve të institucionit.

Promovimi i karrierës ushtarake

Pjesëmarrja në panairin “Work & Study” përbën një element të rëndësishëm të strategjisë së promovimit



të programeve të studimit dhe të karrierës ushtarake nga Akademia e Forcave të Armatosura. Përmes këtyre aktiviteteve, institucioni synon të afrojë të rinjtë me vlerat e shërbimit ndaj vendit dhe me mundësitë që ofron një karrierë në strukturat e mbrojtjes.

Karriera ushtarake kërkon përkushtim, disiplinë dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie, por në të njëjtën kohë ofron



mundësi të shumta për zhvillim profesional dhe personal. Oficerët e rinj që diplomohen në Akademinë e Forcave të Armatosura bëhen pjesë e një strukture të rëndësishme për sigurinë kombëtare dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në mbrojtjen e vendit dhe në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë.

Në këtë kuadër, aktivitetet informuese me maturantët shërbejnë edhe për të promovuar vlerat e shërbimit ushtarak dhe për të inkurajuar të rinjtë që të zgjedhin një rrugë profesionale që lidhet me mbrojtjen dhe sigurinë e vendit.

Një aktivitet që shtrihet në të gjithë Shqipërinë

Panairi “Work & Study 2026” po zhvillohet në disa qytete të Shqipërisë dhe pritet të vijojë edhe në qytete të tjera gjatë javëve në vijim. Kjo shtrirje kombëtare i jep mundësi një numri të madh maturantësh që të njihen nga afër me programet e studimit të institucioneve të ndryshme universitare, përfshirë edhe Akademinë e Forcave të Armatosura.

Përmes pjesëmarrjes në këtë aktivitet, akademia synon të krijojë një urë komunikimi me të rinjtë në të gjithë vendin dhe të prezantojë mundësitë që ofron për studim dhe karrierë. Në të njëjtën kohë, ky aktivitet kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për rëndësinë e rolit të Forcave të Armatosura në sigurinë dhe stabilitetin e vendit.

Pjesëmarrja e Akademisë së Forcave të Armatosura në panairin “Work & Study 2026” përfaqëson një hap të rëndësishëm në drejtim të promovimit të studimeve ushtarake dhe të afrimit të të rinjve me mundësitë që ofron një karrierë në shërbim të vendit. Përmes këtyre aktiviteteve, institucioni vazhdon të kontribuojë në formimin e brezit të ri të oficerëve që do të shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

PREKAZI I MARTIRËVE

Kujtesa e Gjallë e Dëshmorëve të Kosovës



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Prekazi: Historia e Guximit dhe Sakrificës
5-7 mars 1998, 58 shqiptarë ranë për lirinë e Kosovës. Sot kujtesa e tyre na flet.
Ndërsa vizitoja Prekazin e Ulët, ndjeva fuqinë e historisë dhe peshën e sakrificës së familjes Jashari. Vendosmëria e tyre për të qëndruar deri në fund, për të mbrojtur dinjitetin dhe lirinë, i ka bërë ata simbol të qëndresës shqiptare. Përtej statistikave dhe raporteve zyrtare, Prekazi është një kujtesë që nuk shuhet.
E vetmja e mbijetuar, Besarta Jasharit: “Ata nuk u dorëzuan. Ata u bënë simbol i qëndresës sonë”.

Historia dhe Prapaskenat
“Para Masakrës: Përleshjet në Drenicë”
Adem dhe Hamëz Jashari ishin komandantë të UÇK-së, që në vitin 1991 organizuan formacionet e para të armatosura politike në Skënderaj. Përplasjet paraprake në Likoshan dhe Qirez, ku u vranë dhjetëra shqiptarë, vendosën tonin për sulmin në Prekaz. Policët serbë kërkonin “neutralizimin” e familjes Jashari, ndërsa ata vendosën të qëndronin dhe të rezistonin.

Sulmi dhe Masakra
5-7 Marsi: Dita Kur Historia Ndryshoi
Më 5 mars 1998, forcat serbe rrethuan kompleksin e Jasharëve. Policia u tha që të dorëzoheshin; familja refuzoi. Ndërsa përleshja shpërtheu, Adem dhe Hamëz Jashari, së bashku me pjesëtarë të tjerë të familjes, ranë në rezistencë. Amnesty International raporton se qëllimi nuk ishte kapja, por eliminimi. Vetëm Besarta Jashari mbijetoi.



Varrimi dhe Kujtesa
Trupat u zhvendosën fillimisht në morgun e Prishtinës dhe më 10 mars u varrosën në një varr masiv pranë Prekazit. Më 11 mars, rivarrimi u bë sipas traditës islame. Përpjekjet për autopsi u penguan, por kujtesa mbeti e gjallë. Prekazi sot është simbol i sakrificës dhe qëndresës.



Prekazi nuk është vetëm një vend, është një histori që nuk harrohet.

Pasojat dhe Reagimi Ndërkombëtar
Reagimi që Ndryshoi Historinë
Pas sulmit, popullariteti i UÇK-së u rrit ndjeshëm. Shqiptarët mobilizuan milicëtë e fshatrave dhe demonstratat në Prishtinë, si dhe ato ndërkombëtare në SHBA dhe Evropë, u bënë simbol i solidaritetit global. Ngjarja ndezi një valë ndërgjegjësimit që kontribuoi drejt Luftës së Kosovës.

Prekazi Sot: Kujtesa e Gjallë
Vizita në Prekaz nuk është një vizitë e zakonshme. Është një përjetim i thellë emocional që e lidh vizitorin me historinë më të dhimbshme dhe më krenare të popullit shqiptar në Kosovë. Në këtë vend, ku toka ruan kujtimin e sakrificës sublime të familjes Jashari dhe të shumë martirëve të tjerë, çdo hap duket sikur flet me zërin e historisë.

Prekazi nuk është thjesht një fshat në hartën e Kosovës. Ai është një simbol i qëndresës, një monument i gjallë i sakrificës dhe një kujtesë e përhershme se liria nuk është dhuratë, por një e drejtë që shpesh fitohet me çmimin më të shtrenjtë jetën.
Kur afrohet drejt kompleksit memorial, vizitori ndjen menjëherë një atmosferë të veçantë. Qetësia e vendit, flamujt kombëtarë që valëviten në erë dhe pamja e varreve të rreshtuara me solemnitat krijojnë një ndjenjë respekti të thellë. Në këtë hapësirë, historia nuk është vetëm një tregim në libra; ajo është e pranishme në çdo gur, në çdo rrugicë dhe në çdo hap që bëhet drejt memorialit.

Një vend që flet me heshtje
Një nga gjërat më të veçanta që përjeton një vizitor në Prekaz është heshtja. Është një heshtje e rëndë, por edhe e mbushur me domethënie. Nuk është një heshtje bosh, është një heshtje që duket sikur ruan kujtimet e një epoke të dhimbshme dhe të lavdishme njëkohësisht.
Në oborrin e kompleksit memorial, flamujt kombëtarë qëndrojnë të ngritur si roje të përhershme të historisë. Vizitorët ecin ngadalë, shpesh në heshtje, duke ndalur para varreve për të vendosur lule ose për të përkulur kokën në shenjë respekti.
Shumë prej tyre janë të rinj, nxënës, studentë, familje të tëra, të cilët vijnë për të parë nga afër vendin ku historia e Kosovës mori një kthesë të rëndësishme.
Disa prej tyre mund të mos kenë jetuar kohën e luftës dhe mund të mos e kuptojnë plotësisht tragjedinë që ndodhi këtu. Por atmosfera e Prekazit është e tillë që historia bëhet e prekshme edhe për ata që nuk e kanë përjetuar atë.

Memoriali, një shkollë e heshtur historie
Kompleksi memorial në Prekaz është më shumë sesa një vend përkujtimi. Ai është një shkollë e hapur historie. Në këtë vend, brezat e rinj mund të mësojnë për sakrificën dhe qëndresën jo vetëm përmes librave, por përmes përvojës së drejtpërdrejtë. Kur sheh varret e rreshtuara të familjes Jashari dhe dëgjon historinë e qëndresës së tyre, është e pamundur të mos reflektosh mbi kuptimin e vërtetë të lirisë. Çdo vizitor që kalon nëpër këtë vend ndjen se po përballet me

një pjesë të rëndësishme të historisë kombëtare. Është një përballje që të bën të mendosh për të kaluarën, por edhe për përgjegjësinë që kemi ndaj së ardhmes.

Vizitorët, brezat që mbajnë gjallë kujtesën
Gjatë vizitës në Prekaz, bie në sy numri i madh i vizitorëve që vijnë nga të gjitha trojet shqiptare dhe nga diaspora. Disa vijnë për herë të parë, ndërsa të tjerë rikthehen çdo vit për të përkujtuar sakrificën e martirëve. Ka familje që sjellin fëmijët e tyre për t'u treguar se çfarë ka ndodhur në këtë vend dhe për t'u mësuar se liria që gëzojnë sot është rezultat i një historie të dhimbshme.
Nxënësit dhe studentët që vizitojnë Prekazin shpesh ndalojnë gjatë para memorialit, duke dëgjuar rrëfimet e mësuesve ose guidave që tregojnë historinë e familjes Jashari. Në ato momente, historia nuk është më vetëm një kapitull në librat shkollorë. Ajo bëhet një përvojë e gjallë që prek mendjen dhe zemrën.

Prekazi si simbol i identitetit kombëtar
Prekazi ka marrë me kalimin e viteve një dimension më të gjerë se ai historik. Ai është bërë një simbol i identitetit kombëtar dhe i sakrificës për liri.
Në kulturën historike të një populli, ka vende që përfaqësojnë momente vendimtare të historisë. Për shqiptarët e Kosovës, Prekazi është një nga ato vende.
Ai përfaqëson jo vetëm një ngjarje tragjike të historisë, por edhe një moment të jashtëzakonshëm të qëndresës dhe vendosmërisë për të mos u dorëzuar.
Për këtë arsye, vizita në Prekaz është një përvojë që tejkalon dimensionin individual. Është një përvojë kolektive që lidhet me kujtesën dhe identitetin e një populli të tërë.

Mesazhi për brezat e rinj
Një nga dimensionet më të rëndësishme të Prekazit sot është mesazhi që ai përcjell për brezat e rinj.
Brezi i ri jeton në një realitet shumë të ndryshëm nga ai i viteve të luftës. Liria që sot duket e natyrshme është në fakt rezultat i sakrificës së shumë njerëzve që besuan në të ardhmen e vendit të tyre.
Vizita në Prekaz është një kujtesë se historia nuk duhet harruar. Ajo është një mësim për përgjegjësinë që secili brez ka për të ruajtur dhe zhvilluar lirinë e fituar.
Brezi i ri duhet ta shohë Prekazin jo vetëm si një vend kujtese, por edhe si një frymëzim për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë, më demokratike dhe më të zhvilluar.

Një vend që nuk duhet harruar
Në fund të vizitës, ndërsa largohesh nga kompleksi memorial, mbetet një ndjenjë e thellë reflektimi.
Prekazi nuk është vetëm një kapitull i historisë së Kosovës. Ai është një kujtesë e përhershme për sakrificën, qëndresën dhe aspiratën për liri.
Në këtë vend ku historia dhe emocioni bashkohen, vizitori e kupton se kujtesa është një nga elementet më të rëndësishme të identitetit të një populli.
Sepse një popull që harron historinë e tij rrezikon të humbasë edhe të ardhmen.
“**Prekazi nuk është vetëm histori; është një thirrje për të mos harruar dhe për të vazhduar rrugën drejt lirisë.**”

DIKUR NË KËTË DATË

11 Mars 1981

Zgjidhja e Vetëdijes Kombëtare



përballën me masa represive politike dhe administrative.

Pas demonstratave, autoritetet jugosllave ndërmorën një fushatë të gjerë represioni politik në Kosovë. Shumë intelektualë, studentë dhe aktivistë politikë u përballën me ndjekje penale, ndërsa institucionet arsimore dhe kulturore u vendosën nën një kontroll më të rreptë politik.

Megjithatë, pavarësisht represionit, demonstratat e vitit 1981 kishin arritur të zgjonin një vetëdije të re politike dhe kombëtare që nuk mund të shtypej lehtësisht.

Ndikimi në zhvillimet politike të mëvonshme

Demonstratat e 11 marsit 1981 konsiderohen sot si një pikë kthese në historinë politike të Kosovës. Ato shënuan fillimin e një procesi të gjatë të mobilizimit politik dhe shoqëror që do të vazhdonte gjatë gjithë viteve '80 dhe '90.

Ngjarjet e vitit 1981 kontribuan në ndërgjegjësimin e opinionit publik ndërkombëtar për situatën politike në Kosovë. Ato gjithashtu krijuan një bazë të re për organizimin politik dhe për artikullimin e kërkesave për të drejtat kombëtare të shqiptarëve.

Në vitet që pasuan, lëvizjet politike dhe shoqërore në Kosovë u zhvilluan në forma të ndryshme, duke përfshirë rezistencën paqësore dhe më vonë rezistencën e armatosur.

Në këtë kuptim, demonstratat e vitit 1981 mund të shihen si një nga gurrthemet e procesit historik që çoi drejt çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës.

Kujtesa historike dhe rëndësia e saj sot

Sot, më shumë se katër dekada pas demonstratave

të vitit 1981, rëndësia e tyre historike mbetet e padiskutueshme. Ato përfaqësojnë një moment kur guximi qytetar dhe ndërgjegjja kombëtare sfiduan një sistem politik që nuk i njihte plotësisht të drejtat dhe aspiratat e shqiptarëve në Kosovë.

Kujtesa e këtyre ngjarjeve është një element i rëndësishëm i identitetit historik dhe politik të Kosovës. Ajo na kujton se rruga drejt lirisë dhe shtetndërtimit ka qenë e gjatë dhe shpesh e vështirë.

Në këtë kuptim, përkujtimi i demonstratave të 11 marsit nuk është vetëm një akt simbolik. Ai është një moment reflektimi mbi historinë dhe mbi përgjegjësinë që brezat e sotëm kanë për të ruajtur dhe zhvilluar vlerat e lirisë, demokracisë dhe dinjitetit njerëzor.

11 marsi i vitit 1981, mbetet një nga datat më domethënëse në historinë moderne të Kosovës. Ai përfaqëson momentin kur një brez i ri studentësh dhe qytetarësh artikuloi publikisht aspiratat për barazi dhe vetëvendosje.

Edhe pse demonstratat u shtypën me forcë, ato lanë një gjurmë të pashlyeshme në historinë politike të Kosovës. Ato shënuan fillimin e një procesi historik që, përmes shumë sakrificash dhe përpjekjesh, do të çonte në realizimin e aspiratës për liri dhe shtetësi.

Në këtë kuptim, 11 marsi nuk është vetëm një datë historike. Ai është simbol i guximit qytetar dhe i vendosmërisë për të kërkuar drejtësi dhe dinjitet.

OBSERVATORI I KUJTESËS

“11 marsi 1981 ishte dita kur zëri i studentëve u bë zëri i një populli të tërë që kërkonte barazi, dinjitet dhe të drejtën për të vendosur për fatin e vet.”

Historia moderne e Kosovës është e mbushur me momente që kanë ndikuar thellësisht në formësimin e vetëdijes kombëtare dhe në rrugëtimin drejt lirisë dhe shtetndërtimit. Ndër këto momente, data 11 mars 1981 zë një vend të veçantë. Ajo shënon fillimin e protestave studentore në Universitetin e Prishtinës, një ngjarje që fillimisht u paraqit si një reagim ndaj kushteve të vështira të jetesës së studentëve, por që shumë shpejt u shndërrua në një lëvizje të gjerë shoqërore me kërkesa të qarta politike dhe kombëtare.

Protestat e 11 marsit përfaqësojnë një nga momentet kyçe në historinë bashkëkohore të Kosovës. Ato shënuan zgjidhjen e vetëdijes politike dhe kombëtare të një brezi të tërë, duke artikuluar publikisht aspiratat për barazi, dinjitet dhe vetëvendosje brenda strukturës federative të ish-Jugosllavisë.

Në këtë kuptim, 11 marsi i vitit 1981 nuk ishte thjesht një protestë studentore. Ai ishte fillimi i një procesi historik që do të ndikonte në zhvillimet politike të Kosovës për dekadat që pasuan.

Konteksti historik dhe politik

Për të kuptuar rëndësinë e demonstratave të vitit 1981, është e nevojshme të analizojmë kontekstin politik dhe shoqëror të kohës. Në periudhën pas Kushtetutës së vitit 1974, Kosova kishte fituar një nivel të caktuar autonomie brenda Federatës Jugosllave. Megjithatë, kjo autonomi nuk përkthehej në barazi të plotë politike, ekonomike dhe institucionale për shqiptarët.

Megjithëse shqiptarët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë në Kosovë, pozita e tyre në strukturën federative mbetej e kufizuar. Kosova nuk kishte statusin e republikës, ndërsa zhvillimi ekonomik dhe social mbetej dukshëm më i ulët krahasuar me republikat e tjera të federatës.

Në këtë kontekst, pakënaqësia shoqërore dhe politike filloi të rritej gradualisht. Universiteti i Prishtinës, si institucioni kryesor arsimor dhe intelektual në Kosovë, u shndërrua në një qendër të rëndësishme të debatit politik dhe të artikullimit të kërkesave për barazi dhe avancim të statusit politik të Kosovës.

Nga kërkesat sociale te aspiratat politike

Protestat e 11 marsit 1981 filluan si një reagim spontan i studentëve ndaj kushteve të vështira të jetesës në konviktet studentore dhe në mensat universitare. Megjithatë, shumë shpejt këto protesta morën një dimension më të gjerë.

Brenda një kohe të shkurtër, protestat u përhapën përtej hapësirës universitare dhe u mbështetën nga një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë kosovare. Studentët dhe qytetarët filluan të artikulojnë kërkesa që shkonin përtej çështjeve sociale dhe përfshinin dimensione të qarta politike dhe kombëtare.

Një nga kërkesat kryesore që u artikulua gjatë këtyre demonstratave ishte kërkesa për statusin e Republikës për Kosovën. Kjo kërkesë përfaqësonte aspiratën për barazi të plotë politike brenda federatës dhe për njohjen e të drejtave të shqiptarëve si popull.

Demonstratat e vitit 1981 shënuan kështu një moment të rëndësishëm në artikullimin publik të kërkesave politike të shqiptarëve në Kosovë.

Reagimi i autoriteteve jugosllave

Autoritetet federative jugosllave reaguan me shqetësim të madh ndaj zhvillimeve në Kosovë. Demonstratat u konsideruan si një sfidë ndaj rendit politik të federatës dhe si një rrezik potencial për stabilitetin e saj.

Si rezultat, protestat u shtypën me forcë nga strukturat e sigurisë dhe të rendit publik. Një numër i madh studentësh dhe qytetarësh u arrestuan, ndërsa shumë të tjerë u



Në historinë e një populli ka figura që shndërrohen në simbol të vlerave më të larta njerëzore dhe kombëtare. Ato nuk kujtohen vetëm për veprat që kanë bërë, por për mesazhin e madh që përcjellin për brezat e ardhshëm. Një nga këto figura të ndritura të historisë shqiptare është heroina **Liri Gero**, një vajzë e re që e lidhi jetën e saj me fatin e atdheut dhe që e kurorëzoi atë me sakrificën më sublime – dhënien e jetës për liri.

Historia e saj nuk është vetëm historia e një luftëtareje partizane. Ajo është historia e një gruaje që në një kohë të vështirë zgjodhi të sfidojë frikën, pushtimin dhe padrejtësinë. Në këtë kuptim, jeta dhe rënia e Liri Geros përfaqësojnë një nga shembujt më të fuqishëm të rolit të gruas shqiptare në luftën për çlirim dhe dinjitet kombëtar.

Rrënjët e një vajze që u bë simbol

Liri Gero lindi, më 4 qershor 1924, në lagjen Shkozë të qytetit të Fierit, në një familje të thjeshtë qytetare. Babai i saj, Tili Gero, ishte rrobaqepës, ndërsa nëna Angelina kujdesej për familjen dhe për rritjen e pesë vajzave.

Si shumë vajza të kohës, edhe Liria u rrit në një mjedis familjar ku puna, përkushtimi dhe respekti për vlerat njerëzore ishin pjesë e jetës së përditshme. Askush nuk mund ta imagjinonte se kjo vajzë e re, e qetë dhe e buzëqeshur, do të bëhej një nga figurat më heroike të Luftës Nacionalçlirimtare.

Megjithatë, në shpirtin e saj bashkëjetonin disa cilësi të rralla: ndjeshmëria, bukuria, vendosmëria dhe një dashuri e thellë për atdheun. Këto cilësi do ta çonin shumë shpejt në rrugën e rezistencës kundër pushtimit fashist dhe nazist.

Hapat e parë në luftën antifashiste

Në pranverën e vitit 1942, Liri Gero filloi aktivitetin e saj antifashist. Ajo u bë pjesë aktive e lëvizjes çlirimtare, duke bashkëpunuar me njësitet guerile të qytetit të Fierit.

Në çantën e saj, në bohçe apo në kanistër, ajo shpesh mbante trakte dhe komunikata të Luftës Nacionalçlirimtare që shpërndareshin në qytet. Në këtë mënyrë ajo kontribuonte në përhapjen e ideve të rezistencës dhe të luftës për çlirim.

Por roli i saj nuk kufizohej vetëm në këtë. Liria shërbente si korriere dhe ndihmonte në organizimin e të rinjve dhe të rejave për t’u bashkuar me radhët e partizanëve. Ajo fliste me shoqet e saj, i bindte dhe i frymëzonte që të merrnin pjesë në luftën për liri.

Me kalimin e kohës, aktiviteti i saj nuk mund të kalonte pa u vënë re nga pushtuesit. Gestapoja gjermane e shpalli të kërkuar dhe e dënoi me vdekje. Kjo e detyroi të kalonte në ilegalitet dhe të strehohej në baza të sigurta.

Nusja që veshi vellon për të dalë partizane

Një nga episodet më të veçanta dhe më simbolike të jetës së Liri Geros lidhet me momentin kur ajo vendosi të dilte partizane.

Liria ishte e njohur për aftësitë e saj artistike. Ajo qepte dhe qëndiste pajat e nuseve, punime që edhe sot ruhen në muzeun historik të Fierit. Por ironia e fatit ishte se ajo nuk e përjetoi kurrë vetë gëzimin e martesës.

Vellon dhe fustanin e bardhë të nusërisë ajo i veshi vetëm një herë në momentin kur doli nga qyteti i Fierit për t’u bashkuar me partizanët.

Për të kaluar shtetrrëthimin e vendosur nga pushtuesit, ajo dhe shokët e saj organizuan një skenë simbolike: një pajton me “krushq”, sikur po shkonin në një dasmë. Në këtë mënyrë, Liria arriti të dalë nga qyteti dhe të bashkohej me radhët e luftëtarëve të lirisë.

Ky moment i veçantë i jetës së saj është përjetësuar edhe në filmin shqiptar **“Nusja dhe shtetrrëthimi”**, i cili i kushtohet këtij episodi të paharruar.

Vajzat e Fierit dhe akti i guximit

Dalja e Liri Geros në luftë nuk ishte një akt i izoluar. Ajo dhe motra e saj Sofia, ishin pjesë e një grupi prej 68 vajzash të qytetit të Fierit që, brenda një dite, vendosën të dilnin partizane.

Ky ishte një akt i jashtëzakonshëm jo vetëm për Shqipërinë, por edhe në kontekstin europian të asaj kohe. Ai tregonte jo vetëm shpirtin e sakrificës për atdheun, por edhe nivelin e emancipimit dhe të ndërgjegjes shoqërore të grave shqiptare.

Në këtë kuptim, Liri Gero dhe shoqet e saj përfaqësojnë një kapitull të rëndësishëm të historisë së rolit të gruas në luftën për liri.

Beteja e fundit

Momenti më dramatik i jetës së Liri Geros ndodhi në tetor të vitit 1944. Ajo ishte skuadërkomandante në batalionin e katërt të Brigadës XVI Sulmuese. Natën e 5 tetorit, batalioni kishte zënë pozicione në zonën Fier–Shegan, nga kodrat e Çukasit deri te ura e Kuçit mbi lumin Seman.

Në agimin e 6 tetorit, partizanët u përballën me një

LIRI GERO – Heroizmi, dinjiteti dhe pavdekësia e një vajze shqiptare



Një simbol që jeton përjetë

Edhe pse jeta e saj u ndërpre tragjikisht, figura e Liri Geros mbetet një simbol i pavdekshëm i trimërisë dhe sakrificës.

Në Varrezat e Dëshmorëve në Fier ruhet një pjesë e hirit të saj, ndërsa në vendin e rënies është ngritur një lapidar në kujtim të betejës ku ajo dhe 13 dëshmorë të tjerë dhanë jetën për atdheun.

Në qytetin e Fierit, busti i saj qëndron si një kujtesë e përhershme e një vajze që u bë simbol i lirisë.

Si feniksi legjendar që ringjallet nga hiri i vet, edhe Liri Gero u ringjall në kujtesën historike të popullit shqiptar.

Të jesh grua: Mesazhi i Liri Geros

Historia e Liri Geros është një mesazh i fuqishëm për rolin dhe dinjitetin e gruas.

Ajo tregon se të jesh grua nuk do të thotë vetëm të jetosh për veten apo për familjen, por edhe të mbash përgjegjësi për fatin e shoqërisë dhe të atdheut.

Në jetën dhe sakrificën e saj bashkëjetonin atdhedashuria, guximi, bukuria dhe vendosmëria. Këto cilësi e bëjnë atë një nga figurat më të ndritura të panteonit të dëshmorëve të Shqipërisë.

Prandaj kujtesa e saj mbetet një frymëzim për brezat e rinj dhe një dëshmi se idealet e lirisë dhe dinjitetit njerëzor janë më të forta se çdo dhunë apo pushtim.

“Liri Gero nuk u bë nuse në jetë, por u bë nuse e pavdekësisë në altarin e lirisë.”

autokolonë të madhe gjermane që përbëhej nga 98 kamionë me trupa dhe teknikë luftarake, pesë tanke, autoblanda dhe motoçikleta.

Luftimet ishin të ashpra dhe të pabarabarta. Megjithatë, partizanët luftuan me trimëri të jashtëzakonshme, deri në përleshje trup më trup me armikun.

Në një moment të betejës, kur një partizan ra në luftë pasi kishte djegur një autobлиндë gjermane, Liria u hodh për ta tërhequr trupin e tij. Në atë çast tre ushtarë gjermanë u sulën drejt saj. Me shpejtësi dhe vendosmëri, ajo i asgjësoi të tre me automatik.

Por beteja vazhdoi dhe Liria u plagos rëndë nga predhat e artilerisë. Megjithatë ajo vazhdoi të luftonte, duke marrë mitralozin e një shoku të rënë.

Vetëm kur i mbaruan fishekët dhe humbi ndjenjat nga hemorragjia, ajo ra në duart e nazistëve.

Martirizimi dhe pavdekësia

Edhe në momentet më të vështira, Liri Gero tregoi një qëndresë të jashtëzakonshme.

Nazistët e torturuan mizorisht dhe kërkuan ta poshtëronin. Por ajo nuk u dorëzua. Me një akt sfidues dhe plot dinjitet, ajo e pështyu në fytyrë oficerin gjerman.

I tërbuar nga humbja e betejës dhe nga qëndrimi i saj krenar, oficeri nazist urdhëroi që Liria të spërkatej me benzinë dhe të digjej e gjallë.

Më 6 tetor 1944, në afërsi të Lushnjës, një nga heroinat më të ndritura të historisë shqiptare u martirizua në mënyrë çnjerëzore.

Nga trupi i saj mbeti vetëm një grusht hi.

Nga uniforma e skënderbegasit te mjeku ushtarak: Rrugëtimi i VASIL ZOGËS

Në historinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë ka shumë figura që kanë shërbyer me përkushtim në uniformë, duke i dhënë jetës së tyre kuptim përmes detyrës, disiplinës dhe dashurisë për atdheun. Ndër këto figura spikat edhe një emër i respektuar i brezit të skënderbegasve, Vasil Zoga, një mjek ushtarak që i përket atij grupi oficerësh që u formuan në një traditë të veçantë arsimimi dhe edukimi ushtarak.

Skënderbegasi Vasil Zoga është pjesë e brezit të atyre të rinjve që u rritën dhe u formuan nën disiplinën e rregullit ushtarak, por që njëkohësisht ndoqën arsimin civil për t'u përgatitur profesionalisht në shërbim të ushtrisë. Ai përfaqëson një brez të tërë të rinjsh që u edukuan me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vendit dhe me bindjen se profesionet civile mund të vireshin në shërbim të mbrojtjes dhe shëndetit të forcave ushtarake.

Fëmijëria dhe rrënjët familjare

Vasil Zoga lindi më 29 maj 1939, në fshatin Shtikë, një zonë e njohur për traditat e saj patriotike dhe për dashurinë ndaj arsimit. Fshati i tij ndodhet në krahinën e Kolonjës, një trevë që historikisht ka nxjerrë shumë intelektualë dhe atdhetarë.

Në këtë mjedis u rrit dhe u edukua Vasili, duke u dalluar që në vitet e para për përkushtimin ndaj mësimave dhe për rezultatet e mira në shkollë. Ai kreu me sukses shkollën fillore dhe shtatëvjeçare në vendlindje, duke treguar një prirje të veçantë për studim dhe disiplinë.

Viti 1953 shënoi një kthesë të rëndësishme në jetën e tij. Falë rezultateve shumë të mira në shkollë, atij iu dha e drejta për të vazhduar studimet në Shkollën Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë, një nga institucionet më të rëndësishme të arsimit ushtarak për të rinjtë shqiptarë.

Për një djalë të ri nga Kolonja, pranimi në këtë shkollë ishte një privilegj dhe një përgjegjësi e madhe. Ai u akomodua në shkollë, veshi uniformën e bukur të skënderbegasit dhe nisi një kapitull të ri në jetën e tij.

Formimi si skënderbegas dhe rruga drejt mjekësisë

Megjithatë, shumë shpejt atij iu komunikua një vendim që do të përcaktonte drejtimin e karrierës së tij. Së bashku me disa shokë të tjerë, ai do të vazhdonte mësimet në një institucion tjetër arsimor, duke mbetur gjithsesi pjesë e kontingjentit të ushtrisë.

Ai do të studionte në Politeknikumi Mjekësor i Tiranës, duke mbajtur uniformën ushtarake dhe duke u përgatitur për të shërbyer si mjek në strukturat e ushtrisë.

Ky vendim nuk e zhgënjeu aspak të riun kolonjar. Përkundrazi, ai e priti me gëzim dhe me një ndjenjë të thellë përgjegjësie. Ai e kuptoi se përpara kishte një rrugë studimi më të gjatë dhe më të vështirë, sepse duhej të përgatitej njëkohësisht si oficer dhe si mjek.

Me përkushtim dhe disiplinë, ai arriti të diplomohej si ndihmësmjek. Duke qenë pjesë e kontingjentit të ushtrisë, ai vazhdoi studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë, një nga institucionet më prestigjioze akademike të vendit në atë kohë.

Studimet universitare e pajisën atë me një formim të plotë profesional dhe shkencor në fushën e mjekësisë, duke e përgatitur për një karrierë të gjatë në shërbim të shëndetit të ushtarakëve.

Specializimi dhe formimi i vazhdueshëm profesional

Etja për dije dhe për përmirësim profesional nuk u ndal me përfundimin e studimeve universitare. Përkundrazi, Vasil Zoga vazhdoi të thellonte njohuritë e tij në fusha të tjera të rëndësishme të mjekësisë.

Ai ndoqi studimet në Instituti i Lartë i Kulturës Fizike “Vojo Kushi” në Tiranë, ku u specializua në degën e mjekësisë sportive dhe të fizioterapisë. Në këtë institucion ai u formua si masazhier fizioterapist, duke



përfunduar studimet me rezultate të shkëlqyera.

Ky specializim ishte veçanërisht i rëndësishëm për strukturat e ushtrisë, pasi lidhej me rehabilitimin fizik të ushtarakëve dhe me trajtimin e dëmtimeve që lidhen me aktivitetin fizik intensiv.

Por interesat e tij intelektuale nuk kufizoheshin vetëm në mjekësi. Ai ndoqi gjithashtu studime në Universiteti Shtetëror i Tiranës edhe në fushën e gjuhës dhe letërsisë, duke treguar një horizont të gjerë kulturor dhe një dashuri të veçantë për dijen.

Ky formim i shumanshëm e bëri atë një figurë të kompletuar profesionale dhe intelektuale.

Shërbimi si mjek ushtarak

Pas përfundimit të studimeve, Vasil Zoga nisi shërbimin e tij në strukturat e ushtrisë shqiptare si mjek ushtarak. Në këtë rol ai u përball me sfida të shumta profesionale, duke u angazhuar në kujdesin shëndetësor të ushtarakëve dhe në përmbushjen e detyrave që kërkonte shërbimi në një institucion kaq të rëndësishëm si ushtria.

Mjekët ushtarakë kanë një rol të veçantë në strukturat e mbrojtjes së një vendi. Ata nuk janë vetëm profesionistë

të shëndetit, por edhe pjesë e disiplinës dhe organizimit ushtarak. Për këtë arsye, profesioni i tyre kërkon një përgatitje të dyfishtë: atë mjekësore dhe atë ushtarake.

Në këtë kuptim, figura e Vasil Zogës përfaqëson modelin e oficerit-mjek që i shërben vendit me profesionalizëm dhe përkushtim.

Emigracioni dhe vazhdimi i jetës në Greqi

Me fillimin e proceseve demokratike në Shqipëri në fillim të viteve '90, shumë shqiptarë u përballën me ndryshime të mëdha sociale dhe ekonomike.

Në këtë periudhë, edhe Vasil Zoga mori vendimin për të emigruar. Ai u vendos në Athinë, në Greqi, ku vazhdoi jetën dhe aktivitetin e tij profesional në emigracion.

Si shumë intelektualë dhe profesionistë shqiptarë të asaj kohe, ai u përball me sfidat e integritetit në një vend të ri, duke u përpjekur të ruante njëkohësisht identitetin dhe vlerat e tij.

Megjithatë, përvoja dhe formimi i tij profesional mbetën gjithmonë një pasuri e vyer që e shoqëroi edhe në këtë kapitull të ri të jetës.

Një jetë në shërbim të dijes dhe detyrës

Jeta e Vasil Zogës është një histori përkushtimi ndaj arsimit, profesionit dhe shërbimit publik.

Nga një djalë i ri nga Kolonja që spikati për rezultatet në shkollë, ai u shndërrua në një profesionist të formuar në disa fusha të dijes: mjekësi, fizioterapi dhe studime humanitare.

Rruga e tij është një shembull i qartë i asaj se si formimi ushtarak dhe ai civil mund të ndërthuren për të krijuar figura të kompletuara profesionale.

Brezi i skënderbegasve, ku ai bën pjesë, ka lënë një gjurmë të rëndësishme në historinë e ushtrisë shqiptare. Ata u edukuan me disiplinë, me ndjenjën e përgjegjësisë dhe me përkushtimin ndaj vendit.

Në këtë kuadër, portreti i Vasil Zogës mbetet një pjesë e kësaj historie.

Ai përfaqëson jo vetëm një mjek ushtarak, por edhe një intelektual që e vlerësoi gjithmonë dijen dhe përgatitjen profesionale.

Historia e tij është një kujtesë se pas uniformës së çdo ushtaraku qëndron një histori personale përpjekjesh, sakrificash dhe përkushtimi ndaj detyrës.

Dhe pikërisht këto histori përbëjnë mozaikun e madh të historisë së ushtrisë shqiptare dhe të njerëzve që i kanë shërbyer asaj me nder.



KONFLIKTI IZRAEL-IRAN

Rivaliteti strategjik që rrezikon stabilitetin e Lindjes së Mesme

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një përballje që shkon përtej një konflikti të zakonshëm

Rivaliteti midis Izraelit dhe Iranit është sot një nga tensionet më të rëndësishme gjeopolitike në botë. Nuk bëhet fjalë vetëm për një konflikt midis dy shteteve, por për një përplasje strategjike që përfshin dimensione ideologjike, ushtarake, teknologjike dhe energjetike.

Për dekada me radhë kjo përballje është zhvilluar në mënyrë indirekte, përmes operacioneve të inteligjencës, luftës kibernetike dhe përdorimit të forcave të ndërmjetme. Megjithatë, zhvillimet e viteve të fundit kanë treguar një përshkallëzim të rrezikshëm që mund të transformojë rivalitetin në një konflikt të hapur rajonal.

Në këtë kontekst, analiza e dimensioneve gjeostrategjike të konfliktit Izrael-Iran është thelbësore për të kuptuar jo vetëm dinamikën e sigurisë në Lindjen e Mesme, por edhe implikimet për stabilitetin global.

Nga aleatë në armiq strategjikë

Marrëdhëniet midis Izraelit dhe Iranit nuk kanë qenë gjithmonë armiqësore. Gjatë periudhës së Shahut Mohammad Reza Pahlavi, Irani ishte një nga partnerët strategjikë të Izraelit në rajon. Bashkëpunimi përfshinte fusha të ndryshme, nga tregtia dhe energjia deri te bashkëpunimi ushtarak dhe i inteligjencës.

Situata ndryshoi rrënjësisht pas Revolucionit Islamik të vitit 1979. Regjimi i ri iranian e shpalli Izraelin si një armik ideologjik dhe një simbol të ndikimit perëndimor në rajon. Që nga ajo periudhë, kundërshtimi ndaj Izraelit është bërë një nga elementet kryesore të politikës së jashtme iraniane.

Nga ana tjetër, Izraeli e konsideron Iranin si kërcënimin më serioz për sigurinë e tij kombëtare, kryesisht për shkak të programit bërthamor iranian dhe përpjekjeve të Teheranit për të zgjeruar ndikimin në rajon.

Rivaliteti për dominimin në Lindjen e Mesme

Në thelb të konfliktit Izrael-Iran qëndron një rivalitet për ndikim dhe dominim në Lindjen e Mesme.

Izraeli synon të ruajë superioritetin e tij ushtarak dhe teknologjik në rajon, duke parandaluar shfaqjen e një fuqie rivale që mund të kërcënojë ekzistencën e tij.

Irani, nga ana tjetër, ka ndërtuar një strategji të zgjerimit të ndikimit rajonal përmes një rrjeti të gjerë aleancash dhe organizatash të armatosura.



Ky rrjet përfshin:

- Hezbollah në Liban
- organizata palestineze në Gaza
- milici shiite në Irak dhe Siri
- lëvizjen Houthi në Jemen

Ky sistem aleancash, shpesh i quajtur **“boshti i rezistencës”**, i jep Iranit një mjet strategjik për të ushtruar presion ndaj Izraelit nga disa drejtime njëkohësisht.

Lufta në hije: Inteligjenca dhe operacionet e fshehta

Për shumë vite konflikti midis dy vendeve është zhvilluar në formën e një **luftë në hije**.

Izraeli ka ndërmarrë një sërë operacionesh të fshehta kundër programit bërthamor iranian, duke përfshirë sabotime industriale, operacione kibernetike dhe eliminimin e disa shkencëtarëve bërthamorë.

Në të njëjtën kohë, Irani ka përdorur organizatat e armatosura aleate për të kryer sulme ndaj objektivave izraelite ose interesave të aleatëve të tij.

Ky model konflikti ka krijuar një situatë të tensionit të vazhdueshëm, por pa kaluar në një luftë të drejtpërdrejtë midis dy shteteve.

Dimensioni ushtarak i përballjes

Izraeli konsiderohet një nga fuqitë ushtarake më të avancuara në botë. Forcat e tij të armatosura disponojnë teknologji moderne, një forcë ajrore shumë të zhvilluar dhe

sisteme të sofistikuara të mbrojtjes raketore.

Doktrina ushtarake izraelite bazohet në parimin e **goditjes parandaluese**, që synon neutralizimin e kërcënimeve para se ato të materializohen.

Irani, nga ana tjetër, ka ndërtuar një strategji të bazuar në luftën asimetrike. Në vend që të konkurrojë drejtpërdrejt me teknologjinë ushtarake izraelite, Teherani ka investuar në:

- zhvillimin e raketave balistike
- prodhimin e dronëve ushtarakë
- ndërtimin e një rrjeti të gjerë milicish rajonale

Kjo strategji i jep Iranit mundësinë të ushtrojë presion ushtarak ndaj kundërshtarëve pa hyrë në një konflikt konvencional të drejtpërdrejtë.

Lufta kibernetike: Fronti i ri i konfliktit

Një nga dimensionet më të rëndësishme të rivalitetit Izrael-Iran është lufta kibernetike.

Sulmet ndaj sistemeve industriale, rrjeteve energjetike dhe infrastrukturës kritike janë bërë pjesë e përditshme e këtij konflikti.

Operacionet kibernetike lejojnë aktorët të shkaktojnë dëme strategjike pa përdorur forcë ushtarake tradicionale dhe pa rrezikuar përshkallëzim të menjëhershëm.

Për këtë arsye, lufta kibernetike konsiderohet sot një nga komponentët kryesorë të konfliktit modern.



Energjia dhe ekonomia: një dimension global

Konflikti Izrael–Iran ka implikime të rëndësishme edhe për ekonominë globale.

Një nga pikat më strategjike në rajon është Ngushtica e Hormuzit, përmes së cilës kalon një pjesë e konsiderueshme e furnizimit global me naftë.

Çdo përshkallëzim i konfliktit në këtë zonë mund të shkaktojë:

- rritje të menjëhershme të çmimeve të energjisë
- destabilizim të tregjeve financiare
- presion inflacionist në ekonominë globale

Për këtë arsye, stabiliteti në Gjirin Persik është një interes strategjik për shumë fuqi të mëdha.

Fuqitë e mëdha dhe balanca globale

Konflikti Izrael–Iran nuk mund të kuptohet pa analizuar rolin e fuqive të mëdha.

Shtetet e Bashkuara mbeten aleati kryesor strategjik i Izraelit dhe një faktor kyç në arkitekturën e sigurisë së rajonit. Mbështetja amerikane përfshin ndihmë ushtarake, bashkëpunim të inteligjencës dhe praninë e forcave ushtarake në Lindjen e Mesme.

Nga ana tjetër, Rusia dhe Kina kanë marrëdhënie të rëndësishme strategjike me Iranin dhe ndjekin me kujdes zhvillimet në rajon.

Balancimi i interesave të këtyre fuqive e bën konfliktin edhe më kompleks dhe e rrit rrezikun e përshkallëzimit ndërkombëtar.

Rivaliteti midis Izraelit dhe Iranit përfaqëson një nga sfidat më të mëdha strategjike të kohës sonë. Ky konflikt ndërthur faktorë historikë, ideologjikë dhe gjeopolitikë dhe ka potencialin të destabilizojë të gjithë rajonin e Lindjes së Mesme.

Ndërsa për dekada përplasja është zhvilluar kryesisht në mënyrë indirekte, dinamika e fundit e zhvillimeve rajonale

tregon se rreziku i përshkallëzimit mbetet real.

Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, stabiliteti në Lindjen e Mesme nuk është vetëm një çështje rajonale, por një faktor i rëndësishëm për sigurinë dhe ekonominë globale.

Lufta, frika dhe shpresa e popujve

Në historinë e njerëzimit, konfliktet kanë qenë shpesh pasqyrë e ambicieve politike, e përplasjeve ideologjike dhe e interesave strategjike. Por përtej analizave gjeopolitike dhe termave diplomatikë, çdo luftë mbart një dimension shumë më të thellë: dimensionin njerëzor. Rivaliteti midis Izraelit dhe Iranit është një nga tensionet më të ndërlikuara të kohës sonë dhe njëkohësisht një kujtesë e fortë se sa e brishtë mbetet paqja në botë.

Ky rivalitet nuk është thjesht një përplasje mes dy shteteve. Ai përfaqëson një konflikt të mbushur me frikë historike, mosbesim ideologjik dhe rivalitet për ndikim rajonal në Lindjen e Mesme. Për dekada të tëra, kjo përballje është zhvilluar në mënyrë indirekte: përmes luftërave të ndërmjetme, operacioneve të inteligjencës dhe përplasjeve në hapësirën kibernetike. Megjithatë, çdo tension i ri ngre një pyetje që shqetëson jo vetëm rajonin, por gjithë botën: çfarë ndodh nëse ky rivalitet shndërrohet në një luftë të hapur?

Historia na mëson se luftërat e mëdha nuk lindin gjithmonë nga vendime të menjëhershme, por nga tensione që akumulohen në heshtje për vite të tëra. Pikërisht kështu filloi edhe Lufta e Parë Botërore në vitin 1914 dhe më pas Lufta e Dytë Botërore në vitin 1939. Ato filluan si konflikte të lidhura me interesa politike dhe ushtarake, por u shndërruan në tragjedi globale që përfshinë miliona njerëz dhe lanë plagë të thella në ndërgjegjen e njerëzimit.

Kur shikojmë tensionet e sotme në Lindjen e Mesme, është e pamundur të mos kujtojmë mësimet e këtyre luftërave. Sepse çdo konflikt i madh fillon me retorikë, me frikë dhe me perceptimin se pala tjetër përbën një kërcënim ekzistencial. Në këtë klimë, arsyetimi shpesh zëvendësohet nga emocioni, ndërsa diplomacia nga logjika e forcës.

Megjithatë, për popujt e zakonshëm, lufta nuk është një koncept strategjik. Ajo është një realitet i dhimbshëm që prek

jetën e përditshme. Lufta është zhurma e sirenave në qytete, ankthi i familjeve që presin lajme nga fronti dhe pasiguria që rëndon mbi çdo të ardhme.

Në qytetin e Izraelit, shumë familje jetojnë me kujtimin e raketave dhe alarmit të mbrojtjes ajrore. Në anën tjetër, në Iran, një popull i tërë përballet me pasiguri ekonomike, izolim ndërkombëtar dhe frikën e një përplasjeje të madhe ushtarake. Edhe pse qeveritë dhe strategët flasin për ekuilibër fuqish, për njerëzit e zakonshëm pyetja është shumë më e thjeshtë: a do të ketë paqe për fëmijët tanë?

Në këtë kuptim, konflikti Izrael–Iran nuk është vetëm një çështje politike. Ai është një dramë njerëzore që përfshin miliona individë të cilët nuk kanë zgjedhur luftën, por duhet të jetojnë me pasojat e saj. Në çdo konflikt të madh, popujt janë ata që paguajnë çmimin më të rëndë.

Lufta gjithmonë premton siguri, por shpesh prodhon vetëm shkatërrim dhe traumë. Shekulli i njëzetë e tregoi këtë me një qartësi tragjike. Lufta e Parë Botërore shkatërroi perandori dhe transformoi hartën politike të Evropës, ndërsa Lufta e Dytë Botërore solli një nivel shkatërrimi që njerëzimi nuk e kishte parë kurrë më parë.

Por më e rëndësishmja është se këto luftëra ndryshuan mënyrën se si njerëzit e kuptojnë paqen. Pas vitit 1945, shumë kombe filluan të kuptojnë se stabiliteti nuk mund të ndërtohet vetëm mbi fuqinë ushtarake. Ai kërkon dialog, institucione ndërkombëtare dhe mbi të gjitha një vullnet të përbashkët për të shmangur përsëritjen e tragjedive të së kaluarës.

Në këtë sfond historik, tensionet mes Izraelit dhe Iranit na detyrojnë të reflektojmë mbi një dilemë të madhe: a do të mësojë njerëzimi nga historia, apo do të vazhdojë të përsërisë të njëjtat gabime?

Në botën moderne, një konflikt i madh në Lindjen e Mesme nuk do të mbetet i kufizuar vetëm në rajon. Ai mund të përfshijë fuqitë e mëdha, të destabilizojë tregjet globale të energjisë dhe të krijojë kriza të reja humanitare. Në një epokë të globalizimit, asnjë luftë nuk është më lokale; çdo konflikt ka pasoja ndërkombëtare.

Megjithatë, edhe në momentet më të errëta të historisë, ka ekzistuar gjithmonë një forcë që i ka rezistuar luftës: shpresa e popujve për paqe. Njerëzit e zakonshëm, pavarësisht kombësisë apo fesë, ndajnë të njëjtat aspirata themelore, siguri, dinjitet dhe një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre.

Kjo është arsyeja pse çdo konflikt duhet të shihet jo vetëm përmes lenteve të strategjisë, por edhe përmes ndjenjave të njerëzve që jetojnë në hijen e tij. Pas çdo vendimi politik ka familje, komunitete dhe breza të tërë që mund të preken nga pasojat.

Në fund të fundit, historia nuk gjykon vetëm fituesit dhe humbësit e luftërave. Ajo gjykon edhe aftësinë e njerëzimit për të zgjedhur paqen në momentet kur lufta duket e pashmangshme.

Rivaliteti mes Izraelit dhe Iranit mbetet një nga sfidat më të mëdha të sigurisë ndërkombëtare. Por ai është gjithashtu një provë për ndërgjegjen globale, një provë që na kujton se paqja nuk është thjesht mungesa e luftës, por një përpjekje e vazhdueshme për të ndërtuar besim, dialog dhe mirëkuptim.

Nëse shekulli i kaluar na ka mësuar diçka, është pikërisht kjo: çdo luftë fillon me një vendim, por paqja fillon me një zgjedhje.

Dhe ndoshta sfida më e madhe e kohës sonë është që njerëzimi të ketë guximin të zgjedhë paqen.

Marsi i përgjakshëm i vitit 1997 dhe betimi që çoi drejt pavdekësisë dy oficerë shqiptarë

Viti 1997 do të mbetet në memorien e shqiptarëve si një vit i tmerrshëm dhe i përgjakshëm. Marsi i vitit 1997 dhe muajt që pasuan, kur shteti u “çmend” dhe futi shqiptarët në një përplasje të pa kuptimtë me njëri-tjetrin, përbëjnë një nga kapitujt më të errët të historisë së Shqipërisë dhe të kombit shqiptar.

Ajo që ndodhi në ato muaj nuk ishte thjesht një krizë politike apo një revoltë sociale. Ishte një shpërbërje dramatike e rendit shtetëror, një situatë ku institucionet u paralizuan dhe shoqëria shqiptare u përball me një realitet tragjik: shqiptarët u gjendën të armatosur përballë njëri-tjetrit, në një konflikt absurd që nuk kishte një armik të jashtëm, por që rrezikonte të shndërrohej në një luftë civile me pasoja të paparashikueshme.

Pasojat e kësaj “luftime pa armik” mbetën një plagë e hapur në ndërgjegjen kombëtare shqiptare. Dhe kjo plagë bëhet edhe më e rëndë për faktin se arkitektët e saj, në pjesën më të madhe, nuk dhanë kurrë llogari për atë që ndodhi. Përkundrazi, në forma të ndryshme, shumë prej tyre u ricikluan në jetën politike dhe ekonomike të vendit, duke shtuar pasuritë dhe pushtetin mbi gjakun, djersën, mundin dhe pronat e shqiptarëve të ndershëm.

Për këtë arsye, marsi i vitit 1997 mbetet një plagë e hapur për sa kohë përgjegjësit kryesorë të asaj tragjedie nuk janë ndëshkuar.

Megjithatë, në mes të këtij kaosi dhe tragjedie kombëtare, historia njih edhe momente të rralla sakrifice dhe heroizmi. Në ato ditë të errëta, pati njerëz që i qëndruan besnikë detyrës, betimit para flamurit dhe përgjegjësisë ndaj vendit.

Ndër ta qëndrojnë me nder dy oficerë të ushtrisë shqiptare: Muhamet Hasmuja dhe Arben Hoxha.

Ata ishin efektivë të Divizionit të Shkodrës dhe më **12 mars 1997**, në përmbushje të detyrës për të mbrojtur repartin dhe për të shpëtuar jetën e efektivit, i qëndruan besnik betimit para flamurit kombëtar dhe flamurit luftarak të njësisë.

Duke mbrojtur detyrën dhe nderin ushtarak, ata ecën drejt pavdekësisë dhe dhanë jetën në krye të detyrës.

Vepra sublime e këtyre dy oficerëve, të shpallur më pas **“Dëshmorë të Atdheut”**, nuk mund të harrohet kurrë. Të gjallët u detyrohen shumë kujtimit, nderimit dhe sakrificës së tyre.

Një vend i armatosur

Ngjarjet e vitit 1997 u shoqëruan me një fenomen të rrezikshëm dhe të paprecedentë në historinë e vendit: hapjen e depove të armatimit dhe armatosjen masive të popullsisë.

Mijëra të rinj humbën jetën gjatë atyre muajve të errët, ndërsa qytete të tëra u përfshinë nga pasiguria dhe dhuna. Në shumë zona të vendit, rendi publik u zhduk dhe armët u kthyen në një realitet të përditshëm.

Edhe Shkodra ishte një nga qytetet që përjetoi momente shumë të rënda. Bilanci i viktimave dhe i plagëve sociale ishte i madh. Megjithatë, falë sakrificës dhe përgjegjësisë së disa oficerëve të policisë dhe ushtrisë, situata nuk u përkeqësua edhe më tej.

Sepse nëse turmat do të kishin arritur të merrnin armë të rënda, si granata apo raketa, pasojat për qytetin dhe për jetën e mijëra njerëzve do të kishin qenë katastrofike.

Mbrëmja tragjike e 12 marsit

Banorët e Shkodrës e kujtojnë ende sot mbrëmjen e 12 marsit 1997, një nga netët më dramatike të historisë së qytetit.


Qindra qytetarë u drejtuan drejt repartit ushtarak dhe baterisë kundër-ajrore që ndodhej në zonën e Dobraçit për të marrë armë.

Në atë repart shërbenin kapiteni i parë Muhamet Hasmuja dhe togeri Arben Hoxha.

Muhamet Hasmuja ishte atëherë 38 vjeç dhe mbante detyrën e komandantit të bazës. Arben Hoxha, me origjinë nga Elbasani, ishte oficer i këtij reparti.

Sipas dëshmive të kolegëve të tyre, situata ishte monitoruar që gjatë ditës.

“Rreth orës 12:00 u bë një inspektim në bazën kundër-ajrore në Dobraç për t’u njohur me masat që oficerët kishin marrë për mbrojtjen e repartit, pasi situata ishte problematike. Muhameti sidrejtues kishte marrë masa shumë të mira dhe gjithçka ishte e organizuar ashtu siç e kërkonte protokollin”, kujtojnë kolegët e tyre.



Por situata ndryshoi shpejt

Orët e mbrëmjes së 12 marsit u shoqëruan me sulme të turmave ndaj reparteve ushtarake në Shkodër. Rreth orës 19:30 ra Divizioni Ushtarak i Shkodrës, ku ndodhej e gjithë komanda e veriut.

Urdhri për drejtuesit e reparteve të tjera ishte i qartë: askush nuk duhej të përdorte armët kundër qytetarëve, por depot dhe godinat e ushtrisë duhej të mbroheshin.

Pak orë më vonë, turma të armatosura u drejtuan drejt baterisë kundër-ajrore në Dobraç.

Kur mbërritën tek reparti, ata tentuan të thyenin barrierat dhe të hynin brenda.

Ushtarët dhe oficerët qëndronin në një anë me armë në duar, por pa urdhër për të qëlluar. Në anën tjetër ndodhej turma, mes së cilës kishte edhe persona të armatosur.

Në atë moment tensioni, komandanti Muhamet Hasmuja mori një vendim të guximshëm.

Ai u fut në mes të turmës dhe ushtarëve të tij, duke u përpjekur të shmangte një përplasje të përgjakshme dhe duke u bërë thirrje qytetarëve të largoheshin.

Plumbat që morën dy jetë

Sipas dëshmisë së ish-shefit të shtabit të regjimentit kundër-ajror, Ndue Marku, momenti tragjik ndodhi papritur.

“Ai po u bënte thirrje qytetarëve që të largoheshin dhe situata të qetësohej. Në një moment, ai u rrëzua. Një dorë e zezë nga turma qëllloi me armë drejt tij. Komandanti nuk u dëgjua më dhe u dha alarmi se Muhameti është qëlluar.”

Për ta ndihmuar u nisën menjëherë oficerët Arben Hoxha dhe Agron Kodra.

Por në atë moment u dëgjua një tjetër breshëri zjarri.

Arben Hoxha u rrëzua i goditur për vdekje, ndërsa oficeri tjetër, Agron Kodra, u qëllua me shtatë plumba. Për fat të mirë ai arriti të mbijetojë.

Duke parë agravimin e situatës, ushtarët u detyruan të qëllonin në ajër për të zmbarsur turmën dhe për t’u mbrojtur nga plumbat.

Shkëmbimi i zjarrit vazhdoi deri rreth orës 3 të mëngjesit

të 13 marsit, kur turma u tërhoq.

Një tragjedi që mund të ishte edhe më e madhe

Trupat e dy oficerëve u transportuan me një kamion drejt spitalit të Shkodrës, ku u njoftuan familjarët. Më pas, trupi i Arben Hoxhës u dërgua në Elbasan, për t’u përcjellë në banesën e fundit nga familja dhe bashkëqytetarët e tij.

Por pyetja që lind edhe sot është: çfarë do të kishte ndodhur nëse reparti kundër-ajror do të kishte rënë në duart e turmave?

Eksptertët ushtarakë janë të qartë në përgjigjen e tyre.

Pasojat do të kishin qenë fatale.

Në atë repart ndodheshin topa kundër-ajrore, raketa në gatishmëri për zjarr dhe sasi të mëdha tritoli. Një pakujdesi sado e vogël, madje edhe një cigare e ndezur, mund të shkaktonte një shpërthim katastrofik.

Pa përmendur rrezikun që armët e rënda të përdoreshin në mënyrë të pakontrolluar.

Pasojat do të kishin qenë tragjike për mijëra njerëz.

Kujtesa dhe nderimi

Në vitin 1998, Këshilli i Qarkut të Shkodrës i shpalli Muhamet Hasmuja dhe Arben Hoxhën **“Dëshmorë të Atdheut”**.

Në nderim të tyre u ngrit edhe një obelisk pranë ish-regjimentit kundër-ajror në zonën e Tepe.

Akti i tyre është dhe do të mbetet një burim frymëzimi për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Sepse në një kohë kur vendi ishte zhytur në kaos dhe pasiguri, ata zgjodhën të qëndrojnë në vendin e detyrës, të mbrojnë jetën e njerëzve dhe të respektojnë betimin e tyre ushtarak.

Sakrifica e tyre është një kujtesë se nderi, përgjegjësia dhe dashuria për atdheun janë vlera që nuk shuhen as në kohët më të vështira.

Emrat e tyre do të mbeten përgjithmonë të gdhendur në historinë e Forcave të Armatosura dhe në kujtesën e popullit shqiptar.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Njohje me autorin

Në hapësirën e mendimit shqiptar mbi çështjet e sigurisë kombëtare dhe të mbrojtjes, botimet që ndërthurin përvojën profesionale ushtarake me analizën publicistike mbeten relativisht të pakta. Në këtë kontekst, veprimtaria botuese e Gani Elezit përfaqëson një kontribut të veçantë në trajtimin analitik të problemeve që lidhen me ushtrinë, sigurinë dhe zhvillimet gjeopolitike në rajon.

I formuar në institucionet kryesore të arsimit ushtarak shqiptar – në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe më pas në Akademinë Ushtarake – autori për disa dekada ka qenë pjesë aktive e strukturave të ushtrisë shqiptare. Përvoja e tij profesionale në reparte dhe njësi të ndryshme ushtarake ka krijuar bazën mbi të cilën është ndërtuar më pas edhe reflektimi i tij analitik dhe publicistik.

Kjo përvojë e drejtpërdrejtë e bën autorin një dëshmitar dhe interpretues të proceseve që lidhen me organizimin, funksionimin dhe transformimet e institucioneve ushtarake në Shqipëri. Në këtë kuptim, shkrimet e tij nuk mbështeten vetëm në vëzhgim të jashtëm, por në një përvojë të përjetuar të realitetit ushtarak dhe institucional.

Në veprimtarinë e tij botuese Gani Elezi ka trajtuar një sërë temash që lidhen me historinë e ushtrisë shqiptare, me zhvillimet e saj në periudha të ndryshme dhe me sfidat e sigurisë në periudhën e tranzicionit. Ndër botimet e tij më të njohura përmenden librat “Kur përgatiteshim për mbrojtje”, “Tej euforisë”, “1997 – Operacioni ushtarak vetëshkatërrues i ushtrisë shqiptare”, “Kalorës të një ëndrre” dhe “Ashtu si unë i kam njohur”.

Një vend të veçantë në këtë veprimtari zë cikli i librave publicistikë të botuar në vitin 2025: “Publicistikë (1) – Shqipëria me halle”, “Publicistikë (2) – Çështje të luftës, sigurisë e mbrojtjes” dhe “Publicistikë (3) – Probleme të shqiptarëve në Kosovë e troje”. Këto vëllime përbëjnë një korpus shkrimesh analitike që trajtojnë zhvillimet politike dhe strategjike në Shqipëri, në rajon dhe në kontekstin ndërkombëtar.

Përveç librave, Gani Elezi është autor i qindra shkrimeve të botuara në shtypin shqiptar, ku trajton probleme politike, çështje të sigurisë dhe të mbrojtjes, si dhe tema të tjera që kanë preokupuar opinionin publik shqiptar.

Bashkëpunëtor i shtypit për çështje të luftës, sigurisë dhe mbrojtjes

Në librin “Publicistikë (2)” autori ka përmbledhur një pjesë të shkrimeve të botuara ndër vite në organe të ndryshme të shtypit dhe në rrjetet sociale, sidomos në faqen e tij në Facebook, të cilat trajtojnë problematika të luftës, sigurisë dhe mbrojtjes.

Ndërkohë, shkrimet e botuara para vitit 1990 në shtypin ushtarak - në gazetën “Luftëtari” dhe në revistat “Për mbrojtjen e atdheut”, “Mbrojtja”, “10 Korriku” etj., - autori synon t’i mbledhë në një botim të veçantë, si dëshmi e formimit të tij profesional dhe e kulturës ushtarake të kohës.


Edhe në vitet pas 1990-s ai ka qenë aktiv në shtyp, kryesisht përmes intervistave në gazeta si “Gazeta Shqiptare”, “Telegraf” etj., ku ka trajtuar probleme të ushtrisë dhe të mbrojtjes. Disa prej tyre lidhen edhe me episode të veçanta historike, si përgatitja ushtarake e një grupi luftëtarësh palestinezë në vitin 1971 në Zall-Herr të Tiranës.

Një pjesë e madhe e shkrimeve të përfshira në këtë vëllim i përkasin periudhës pas vitit 2013, kur rrjetet sociale krijuan mundësi më të mëdha komunikimi publik. Këto shkrime janë marrë kryesisht nga faqja e autorit në Facebook, ndërsa një pjesë e mirë e tyre janë botuar edhe në shtypin e përditshëm.

Shkrimet e tij janë botuar në gazeta si “Shekulli”, “Dita” dhe “Panorama”, si dhe në portale të ndryshme online, ndër të cilat edhe në faqen letrare “Albania Press” në Itali.

Në këtë kuadër, Elezi thekson se Shqipëria dhe shqiptarët ndodhen shpesh përballë sfidave strategjike që kërkojnë qartësi vizioni dhe përgatitje serioze shtetërore. Ai ngre me këmbëngulje nevojën e forcimit të kapaciteteve mbrojtëse të vendit dhe të ruajtjes së një ushtrie profesionale, të aftë për t’u përballur me situata të papritura sigurie.

Nga përvoja ushtarake te analiza publicistike: Gani Elezi, analisti i sfidave të sigurisë shqiptare



Autor i një publicistike për çështje ushtarake

Librat “Publicistikë (1)”, “Publicistikë (2)” dhe “Publicistikë (3)” përbëjnë një korpus të rëndësishëm shkrimesh analitike, të nxitura nga ngjarje, zhvillime dhe vendime politike e ushtarake në Shqipëri dhe në arenën ndërkombëtare.

Në këto botime autori analizon situata konkrete, paraqet realitete të kohës dhe shtron gjykime të argumentuara mbi çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes. Vëmendje të veçantë i kushton zhvillimeve në Ballkan, të cilin e sheh si një rajon historikisht të trazuar, ku shpesh përplasen interesa gjeopolitike dhe rishfaqen tensione të reja.

Sipas autorit, në çdo krizë ballkanike Shqipëria dhe shqiptarët përballen me sfida të mëdha historike. Për këtë

arsye ai thekson nevojën për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit dhe për ruajtjen e një ushtrie profesionale që të shërbejë si faktor sigurie dhe stabiliteti.

Në analizat e tij, Elezi i trajton çështjet e luftës dhe të mbrojtjes jo vetëm në kuadër të territorit të Shqipërisë, por edhe në kontekst më të gjerë rajonal dhe europian. Ai nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit dhe të forcimit të arkitekturës së sigurisë europiane.

Në faqet e librave gjejmë gjithashtu vlerësime për kolegë dhe drejtues të ndryshëm ushtarakë, si dhe për kontributet e tyre në fushën e mendimit ushtarak dhe të botimeve profesionale. Një nga tiparet dalluese të kësaj publicistike është përpjekja për ta vendosur problematikën shqiptare në një kontekst më të gjerë rajonal dhe ndërkombëtar. Ballkani paraqitet në analizat e autorit si një hapësirë historikisht e ndjeshme, ku interesat e fuqive të mëdha shpesh kryqëzohen dhe ku tensionet politike mund të marrin herë pas here dimensione të rrezikshme.

Një temë e rëndësishme që trajtohet në këto botime është koncepti i Kontrollit Civil mbi Forcat e Armatosura, një parim themelor në sistemet demokratike. Autori argumenton se ky parim shpeshherë nuk është kuptuar drejt në praktikën shqiptare dhe në raste të veçanta është përdorur për interesa partiake.

Sipas tij, Forcat e Armatosura duhet t’i nënshtrohen autoritetit të institucioneve civile të zgjedhura politikisht - Parlamentit, Presidentit, Qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes - por ky kontroll nuk duhet të

shndërrohet në instrument politik apo ekonomik.

Në thelb, Kontrolli Civil synon të garantojë që ushtria të mbetet një institucion profesional në shërbim të mbrojtjes kombëtare dhe të mos përfshihet në jetën politike. Përmes këtij parimi forcohet profesionalizmi ushtarak dhe sigurohet respektimi i Kushtetutës dhe i të drejtave të qytetarëve.

Në këtë kontekst, autori sjell edhe shembuj nga praktika ndërkombëtare, si rasti i dorëheqjes së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Francës për shkak të mosmiratimit të buxhetit të propozuar për mbrojtjen, një akt që dëshmon standardet e larta të përgjegjësisë institucionale në shtetet demokratike.

Vlerat e botimeve

Në fund të librit “Publicistikë (2)” autori përfshin edhe një ese të titulluar “Lufta e Armatosur”, e cila paraqitet si një projekt më i gjerë studimor që ai synon ta zhvillojë më tej në të ardhmen, duke përfshirë edhe mendimet e ushtarakëve të brezave të ndryshëm.

Botimet e Gani Elezit përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në fushën e publicistikës ushtarake shqiptare. Ato mbartin vlera njohëse, profesionale dhe shoqërore, pasi trajtojnë me seriozitet probleme të rëndësishme të sigurisë kombëtare dhe të zhvillimeve politike në vend.

Me përvojën e tij të gjatë si ushtarak dhe analist, autori sjell në këto libra vëzhgime, reflektime dhe sugjerime që kanë vlerë për studimin dhe kuptimin e çështjeve të mbrojtjes dhe të sigurisë.

Në tërësinë e tyre, shkrimet e përfshira në këtë vëllim përfaqësojnë një përpjekje për të ndërtuar një diskurs më të qëndrueshëm mbi çështjet e sigurisë kombëtare në hapësirën publike shqiptare. Ato shquhen për prirjen analitike, për përpjekjen për të argumentuar pozicionet e autorit dhe për përfshirjen e problematikës shqiptare në kontekstin më të gjerë të zhvillimeve rajonale dhe ndërkombëtare.

Për këtë arsye, cikli i librave publicistikë të Gani Elezit mund të konsiderohet si një kontribut me vlerë në literaturën shqiptare që trajton çështjet e mbrojtjes, të sigurisë dhe të zhvillimeve strategjike në rajon. Në të njëjtën kohë, ai përbën edhe një dëshmi të përpjekjes për të sjellë përvojën dhe reflektimin e profesionistëve të fushës ushtarake në debatin publik dhe akademik shqiptar.

Pasojat e Luftës në Ekonomi, Shoqëri dhe Mjedis

Ekonomia nën tronditje të vazhdueshme

Lufta nuk është vetëm një përplasje ushtarake, por edhe një goditje e drejtpërdrejtë ndaj ekonomisë globale. Çmimet e energjisë janë rritur ndjeshëm, duke e bërë naftën dhe gazin më të shtrenjtë se kurrë. Kjo ka pasojat menjëhershme: transporti bëhet më i kushtueshëm, prodhimi industrial ngadalësohet, ndërsa familjet e zakonshme përballen me fatura të larta të energjisë. Inflacioni është bërë një fenomen i përhapur, duke ulur fuqinë blerëse të qytetarëve dhe duke e bërë jetën e përditshme më të vështirë.

Në kontekstin e luftës në Lindjen e Mesme, konflikti ka ndërprerë zinxhirët e furnizimit me naftë, gaz dhe produkte bujqësore, duke ndikuar drejtpërdrejt në tregjet globale të energjisë dhe ushqimit. Shkatërrimi i infrastrukturës: porte, rafineri, rrugë dhe ura, kërkon investime të mëdha për rindërtim, por kompanitë private shpesh hezitojnë të hyjnë në zona të pasigurta për shkak të rrezikut të lartë politik dhe ushtarak. Kjo krijon një cikël të vështirë: pa stabilitet nuk ka investime, pa investime nuk ka zhvillim ekonomik, dhe mungesa e zhvillimit ushqen më tej pasigurinë sociale e politike.

Shoqëria e plagosur nga kriza humanitare

Në planin social, lufta sjell pasojat të rënda dhe afatgjata. Miliona njerëz janë detyruar të braktisin shtëpitë e tyre, duke u bërë refugjatë në vendet fqinje ose më larg. Kjo ka krijuar një krizë humanitare të përmasave të mëdha, ku vendet pritëse përballen me presion të jashtëzakonshëm për të siguruar strehim, ushqim dhe shërbime bazë. Për shembull, Polonia ka pritur miliona refugjatë ukrainas, duke e vënë sistemin e saj shëndetësor dhe arsimor nën presion të madh. Pasojat nuk ndalen këtu: shoqëritë përjetojnë trauma kolektive, ndarjet sociale dhe rritje të tensioneve politike. Papunësia rritet, pabarazitë thellohen, dhe shumë familje humbasin burimet kryesore të jetesës. Lufta gjithashtu nxit polarizim politik dhe rritje të ekstremizmit, duke e bërë më të vështirë ndërtimin e paqes dhe stabilitetit afatgjatë. Në këtë kuadër, shoqëria jo vetëm që përballlet me humbje të jetëve njerëzore, por edhe me një plagë të thellë psikologjike që do të kërkojë vite për t'u shëruar.

Mjedisi – Viktima e heshtur e luftës

Megjithatë, aspekti më pak i diskutuar, por më i rrezikshmi, është ndikimi i luftës në mjedis. Bombardimet, shpërthimet dhe djegia e rafinerive çojnë në çlirimin e kimikateve toksike që ndotin ajrin dhe ujin. Lumenjtë dhe liqenet përthithin substanca të rrezikshme, duke e bërë ujin të papërdorshëm për bujqësi apo konsum. Tokat kontaminohen nga metale të rënda dhe mbetje të armëve, duke i bërë të papërshtatshme për kultivim për dekada. Biodiversiteti pëson dëme të mëdha, pasi ekosistemet e ndjeshme shkatërrohen nga aktivitetet ushtarake. Pyjet digjen, fushat shkatërrohen, dhe shumë specie humbasin habitatin e tyre natyror. Përveç kësaj, lufta rrit ndjeshëm emetimet e karbonit, duke përkeqësuar krizën klimatike globale. Ndryshe nga ekonomia dhe shoqëria, të cilat mund të rikuperohen me kohë, mjedisi shpesh nuk kthehet kurrë në gjendjen e mëparshme. Dëmet ekologjike janë të pakthyeshme dhe ndikojnë në brezat e ardhshëm.

Shembuj konkretë nga konfliktet aktuale

Në Ukrainë, bombardimet kanë shkatërruar fusha të tëra bujqësore, duke lënë pas tokë të kontaminuar me metale të rënda. Organizatat ndërkombëtare paralajmërojnë se rikuperimi i këtyre tokave mund të zgjasë dekada. Në Lindjen e Mesme, djegia e rafinerive të naftës ka çliruar sasi të mëdha dioksidi karboni dhe substancash toksike, duke ndikuar në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e popullatës. Në Afrikë, konfliktet e brendshme kanë çuar në shkatërrimin e pyjeve tropikale, duke rrezikuar biodiversitetin unik të rajonit. Këto shembuj tregojnë se mjedisi është viktima më e heshtur, por edhe më e rëndësishme e luftës.

Perspektiva dhe rreziqet afatgjata

Nëse ekonomia mund të rikuperohet me investime dhe stabilitet politik, dhe shoqëria mund të shërohet përmes integritetit dhe mbështetjes sociale, mjedisi mbetet më i brishti. Pasojat ekologjike të luftës janë afatgjata dhe shpesh të pakthyeshme. Ndërsa një urë mund të rindërtohet dhe një fabrikë mund të rifillojë prodhimin, një pyll i djegur kërkon dekada për t'u rikuperuar, dhe një tokë e kontaminuar mund të mbetet e pashfrytëzueshme për breza të tërë. Kjo e bën mjedisin viktimën më të heshtur, por edhe më të rëndësishme të luftës. Pa



një mjedis të shëndetshëm, as ekonomia dhe as shoqëria nuk mund të funksionojnë normalisht. Statistikat ndërkombëtare tregojnë se luftërat aktuale kanë sjellë rritje të inflacionit global mbi 6%, zhvendosjen e mbi 114 milionë njerëzve dhe ndotje të mjedisit që mund të zgjasë për dekada. Ekonomia, shoqëria dhe mjedisi janë të gjitha të goditura, por dëmet ekologjike janë më afatgjata dhe shpesh të pakthyeshme.

Pasojat Ekonomike me Statistika

- Inflacioni global: Organizatat ndërkombëtare raportojnë se lufta në Ukrainë dhe konfliktet e tjera kanë shtyrë inflacionin mesatar global mbi 6%, duke rritur çmimet e energjisë dhe ushqimeve.



- Shkatërrimi i infrastrukturës: Kostot e rindërtimit pas luftës arrijnë në miliarda dollarë. Vetëm Ukraina ka humbur mbi 150 miliardë USD në infrastrukturë të shkatërruar.

- Papunësia: Në vendet e prekura, papunësia rritet ndjeshëm. Kosova pas luftës së viteve '90 raportoi papunësi mbi 20%, duke treguar se efektet zgjasin për dekada.

Pasojat Shoqërore

- Zhvendosjet masive: Sipas OKB-së, numri i refugjatëve dhe personave të zhvendosur për shkak të konflikteve ka arritur në mbi 114 milionë në vitin 2024 – shifra më e lartë e regjistruar ndonjëherë.

- Kriza humanitare: Vendet pritëse si Polonia kanë pritur mbi 3 milionë refugjatë ukrainas, duke vënë nën presion sistemet shëndetësore dhe arsimore.

- Trauma psikologjike: Studimet tregojnë se mbi 60% e fëmijëve në zonat e luftës shfaqin simptoma të stresit post-traumatik, duke krijuar pasojat afatgjata për gjeneratat e ardhshme.

Pasojat Mjedisore

- Ndotja e ajrit dhe ujit: Bombardimet dhe djegia e rafinerive çojnë në çlirimin e kimikateve toksike. Në Ukrainë, raportet tregojnë se mbi 30% e tokave bujqësore janë kontaminuar me metale të rënda.

- Shkatërrimi i biodiversitetit: Konfliktet në Afrikë kanë çuar në humbjen e mijëra hektarëve pyje tropikale, duke rrezikuar specie të rralla.

- Emetimet e karbonit: Lufta rrit ndjeshëm emetimet. Djegia e rafinerive në Lindjen e Mesme ka çliruar miliona tonë CO₂, duke përkeqësuar krizën klimatike.

- Tokë e pashfrytëzueshme: Ekspertët paralajmërojnë se disa zona të Ukrainës mund të mbeten të papërshtatshme për bujqësi për 50 vite për shkak të kontaminimit.

Perspektiva

Ekonomia mund të rikuperohet me investime dhe stabilitet politik.

Shoqëria mund të shërohet përmes integritetit dhe mbështetjes sociale, por plagët psikologjike mbeten.

Mjedisi është më i brishti: dëmet ekologjike janë të pakthyeshme dhe ndikojnë në brezat e ardhshëm. Pa një mjedis të shëndetshëm, as ekonomia dhe as shoqëria nuk mund të funksionojnë normalisht.

Luftëtari i Padukshëm: Teknologjia “Stealth” dhe Revolucioni në Aviacionin Ushtarak

Në historinë e aviacionit ushtarak, çdo gjeneratë ka sjellë një hap të madh përpara: nga motorët me piston tek avionët reaktivë, nga bombarduesit strategjikë tek dronët autonomë. Por ndër të gjitha këto zhvillime, teknologjia “stealth” ka qenë ndoshta më transformuese. Ajo nuk synon vetëm fuqinë e zjarrit apo shpejtësinë, por synon diçka më të sofistikuar: padukshmërinë. Një avion që nuk shihet është një avion që ka epërsi absolute në fushëbetejë.

Arkitektura e Dizajnit: Shkenca e Formës

Dizajni i avionëve “stealth” është një simfoni e matematikës dhe inxhinierisë. Çdo kënd, çdo sipërfaqe, çdo linjë është menduar për të shmangur reflektimin e valëve të radarit. Krahët nuk janë thjesht për ngritje, por janë pjesë e një strukture që shpërndan sinjalet elektromagnetike në mënyrë të tillë që ato të mos kthehen tek antenat e radarëve. Grykat e motorëve janë të fshehura brenda trupit, duke reduktuar gjurmën infra të kuqe. Kabina është e integruar në mënyrë të tillë që të mos krijojë reflektime të panevojshme. Ky dizajn e bën avionin të duket, për radarët, si një objekt i vogël ose i parëndësishëm.

Materialet e Avancuara: Padukshmëria e Ndërtuar

Teknologjia “stealth” nuk është vetëm çështje forme, por edhe çështje materiali. Avionët përdorin përbërje të veçanta që thithin energjinë elektromagnetike. Boja e tyre nuk është dekorative, por një shtresë funksionale që redukton gjurmën radarike. Fibrat e karbonit dhe kompozitet e avancuara i japin avionit jo vetëm padukshmëri, por edhe rezistencë ndaj kushteve ekstreme të fluturimit. Këto materiale janë të afta të përballojnë temperaturat e larta të motorëve dhe presionet e mëdha të lartësive pa humbur vetitë e tyre.

Sistemet Elektronike: Inteligjenca e Padukshme

Një avion “stealth” nuk mbështetet vetëm tek dizajni fizik. Ai është i pajisur me sisteme elektronike që mund të manipulojnë sinjalet e radarëve. Pajisjet e brendshme gjenerojnë kundërmasa elektronike, duke e bërë avionin të duket si një objekt i vogël ose duke e zhdukur krejtësisht nga ekranet e radarëve. Komunikimet e tij janë të koduara dhe të sigurta, duke shmangur përgjimet. Integrimi me inteligjencën artificiale i jep pilotit aftësinë të marrë vendime të shpejta dhe të menaxhojë sisteme komplekse pa humbur fokusin tek misioni.

Avantazhet Strategjike: Epërsia e Padukshme

Avionët “stealth” përfaqësojnë një ndryshim të madh në balancën e fuqisë ushtarake. Ata mund të depërtojnë në hapësira ajrore të mbrojtura pa u zbuluar, duke goditur objektiva strategjikë me saktësi të lartë. Kjo aftësi i bën sistemet tradicionale të mbrojtjes ajrore më pak efektive. Për më tepër, avionët “stealth” nuk janë vetëm mjete sulmuese; ata janë platforma që mund të mbledhin inteligjencë, të monitorojnë lëvizjet e armikut dhe të koordinojnë operacione komplekse pa u vënë re.

Sfida dhe Debat: Çmimi i Padukshmërisë

Megjithatë, teknologjia “stealth” nuk është pa sfida. Kostoja e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së këtyre avionëve është jashtëzakonisht e lartë, duke i bërë ata të përballueshëm vetëm për shtetet me buxhete të mëdha ushtarake. Përveç kësaj, përdorimi i teknologjive që e bëjnë luftën më të paparashikueshme ngre pyetje etike: a po e bën kjo teknologji luftën më të rrezikshme për civilët? Ndërkohë, radarët po evoluojnë. Sistemet e reja të zbulimit po përdorin valë të gjata, sensorë infra të kuq dhe algoritme të inteligjencës artificiale për të kapur gjurmët e avionëve “stealth”. Kjo krijon një garë të vazhdueshme mes padukshmërisë dhe zbulimit.



Një Epokë e Re në Aviacion

Avioni “stealth” është më shumë se një mjet ushtarak; ai është një simbol i epokës së re të aviacionit. Ai përfaqëson kombinimin e shkencës, teknologjisë dhe strategjisë në një

formë të vetme. Në të ardhmen, përplasja mes padukshmërisë dhe zbulimit do të përcaktojë ritmin e zhvillimit të aviacionit ushtarak. Luftëtari i padukshëm nuk është thjesht një avion – është një paradigmë e re e fuqisë ajrore.





NOTIM

Qendra e Personel Rekrutimit njofton se ka filluar regjistrimin e kandidatëve për **200 (dyqind) ushtarë/detarë aktivë**, të cilët do të shërbejnë në funksione dhe vend-dislokime sipas nevojave të Forcave të Armatosura.

Periudha e Stërvitjes

Stërvitja Individuale Bazë do të zhvillohet nga **18 maj deri më 24 korrik 2026**, në qendrat e përcaktuara të trajnimit. Kandidatët e përzgjedhur do të përgatiten për të përballuar sfidat e shërbimit aktiv dhe për të kontribuar në mbrojtjen e vendit.

Afati i Dokumentacionit

Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm duhet të bëhet deri më **17 prill 2026**.